

Xhevdet Bajraj u lind në Panorc të Malishevës. Pas shkollës fillore dhe të mesme studioi për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Fakultetin Filologjik në Universitetin e Prishtinës. Deri në vitin 1999 jetoi në Rahovec, ndërsa pasi iu ofrua bursa e Parlamentit Ndërkombëtar të Shkrimtarëve, shkoi në Meksikë, ku aktualisht jeton dhe vepron. Ai është profesor në Akademinë e Krijimtarisë Letrare në Universidad Autónoma de la Ciudad de México (UACM) në Meksiko Sittit.

Krijimtaria e tij është e përkthyer në disa gjuhë dhe gjithashtu, është vlerësuar me çmime të ndryshme. Ajo është përfshirë nëpër antologji të ndryshme në gjuhë gjuhë të huaja në të cilat përfaqëson poezinë shqipe dhe ate meksikane.



(fq. 2)

XHEVDET BAJRAJ: Jetoj në vendlindjen e realizmit magjik dhe i mbart të gjitha plagët e trojeve shqiptare brenda vetes

Bisedoi Andreas Dushi

Ikja e poetit Lawrence Ferlinghetti

(fq. 9)

Korpusi kadarean: VARIANTE TITULLORE NË AREALIN FRANKOFON

Dr. Jorina Kryeziu (Shkreta)

(fq. 14)

Violeta Volumi, ndonëse është diplomuar në fizikë, në vitin 2015, vendosi të krijojë audiolibrin e parë shqip.

Audiolibri më përkund me zërin e malluar të nënës sime

(fq. 7)

Tre poetë për gjyshen, nënën kur largohet nga jeta

ARAPI • RESHPJA • RUSI

Elsa Balliu

(fq. 13)

Shënime për librin "Letërsia shqipe si metafizikë dhe transhendencë" i Ermira Alija

GJURMËT

Nga Britni Gera

(fq. 8)

STUDIM MBI PAKICËN SHQIPTARE TË RUMANISË

Nga Mira Skënderi

Një prezantim shkencor poliedrik dhe i shumanshëm i atyre që gjatë dy shekujve të fundit kanë kontribuar për zhvillimin e vendit të prindërve të tyre dhe, në të njëjtën kohë, të vendit që është bërë atdheu i dytë e tyre, të Rumanisë.

(fq. 8)

4 mars 1916-2021
105 VJETORI I LINDJES SË PIKTORIT
NEXHMEDIN ZAJMI

(fq. 12)

FILLIMET E IDEOLOGJISË ALBANISTE NË SHEK. XVIII: PAL MARIA PARRINO DHE VEPRA E TIJ

Nga Matteo Mandalà

(fq. 5)

Dhoma më vete: Aty ku disa nga shkrimtarët më të mira krijuan art

Lauren Marino për hapësirat ku shkruan Virginia Woolf, Toni Morrison, Jane Austen, Maya Angelou, motrat Brontë dhe J.K. Rowling.

(fq. 19)

A është "Ana Karenina" një roman dashurie?

Joshua Rothman
The New Yorker



(fq. 21)

BIBLIOTEKË

Zef Zorba

Tjera blerine

(fq. 17)

Visar Zhiti

Edës time në ditën e saj

(fq. 17)

Ridvan Dibra

Muri

(fq. 17)

Egla Xhemali

Greis

(fq. 17)

Nurie Emrullai

E fyti thahet nga këto mendime

(fq. 16)

Poezi amerikane

Përkthyer nga Roland Gjoza

(fq. 18)

TRI LETRA TË PANJOHURA TË POETIT MANUSH PESHKËPIA

Nga Uran Butka

(fq. 10)

Pikërisht ditën e 26 shkurtit 2021, të premtën, pra, ditën e përvjetorit të 70-të të pushkatimit të poetit Manush Peshkëpia më 26 shkurt 1951, zbulova në Arkivin e Shtetit tri letra të panjohura të tij, që mbajnë datat 30 qershor 1944, 31 korrik 1944 dhe 17 gusht 1944, fondi 54, dosja 67 dhe që i drejtohen Sotir Kolesë, atdhetarit dhe dijetarit të shquar.

KONCEPTI HEGELIAN I "VDEKJES SË ARTIT" DHE PIKTURA E LEKË TASIT

Një syzim estetik

Nga Stefan Çapaliku

(fq. 9)

XHEVDET BAJRAJ: Jetoj në vendlindjen e realizmit magjik dhe i mbart të gjitha plagët e trojeve shqiptare brenda vetes

Bisedoi Andreas Dushi

Xhevdet Bajraj u lind në Panorc të Malishevës. Pas shkollës fillore dhe të mesme studioi për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Fakultetin Filologjik në Universitetin e Prishtinës. Deri në vitin 1999 jetoi në Rahovec, ndërsa pasi iu ofrua bursa e Parlamentit Ndërkombëtar të Shkrimtarëve, shkoi në Meksikë, ku aktualisht jeton dhe vepron. Ai është profesor në Akademinë e Krijimtarisë Letrare në Universidad Autónoma de la Ciudad de México (UACM) në Meksiko Siti.

Krijimtaria e tij është e përkthyer në disa gjuhë dhe gjithashtu, është vlerësuar me çmime të ndryshme. Ajo është përfshirë nëpër antologji të ndryshme në gjuhë gjuhë të huaja në të cilat përfaqëson poezinë shqipe dhe ate meksikane.



dhimbje lindin poezitë e mia. Nxjerrin kokë si bimët dhe çelin lule të dhembjes me fytyrë njeriu universal.

Ky është një proces dhe jo një vendim. Në të ka edhe dhimbje meksikane a siriane. Ka lexues në gjuhën spanjolle që nuk e kanë idenë se ku gjendet Kosova, por që iu arrin në zemër poezia ime. Kosova dhe letërsia e saj, për mua nuk kanë qenë asnjëherë në një relacion dashurie mes vete, kështu që vetëm Kosovën e mora me vete dhe një pjesë shumë, shumë të vogël nga autorët e viseve tona.

Mbase kjo, dhembja, është karakteristikë e gjeneratës së parë të emigracionit dhe si e tillë është një proces, proces i dhimbshëm, i natyrshëm.

A. D: Ndonëse studimet për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi i keni ndjekur në Prishtinë, kur u larguat, ju filluat të shkruani në spanjisht. Si jetojnë këto dy gjuhë brenda jush?

Xh. B: Spanjishtja nuk është gjuha e parë e huaj që e kam njohur, por është gjuha e parë e huaj me të cilën më duhet të komunikoj përditë dhe më është dashur të futem thellë në të, përndryshe si do t'ua mësoja studentëve poezinë, shkrimin e saj, leximin e saj, bashkëjetesën me të?! Edhe pse i kisha ca libra të botuar në Kosovë, që mund të numëroheshin në gishtat e një dore, ata njiheshin edhe për vetë faktin se ishin të shpërblyer. Por jetoja në Rahovec, pra, në provincë, nuk jam njeri që imponohem kështu që "ishim marr vesh" me elitën e shpifur që ata të më injorojnë mua dhe unë ta injoroj komplet atë.

Pas luftës, z. Fatmir Sulejmani, ish kryeredaktor i revistës dhe i Shtëpisë Botuese *Brezi 9* me seli në Tetovë, Maqedonia e Veriut, përkujdesej për botimin e librave të mi në gjuhën shqipe. Jo vetëm që përkujdesej, por më presiononte, m'i nxirrte si me zor, insistonte që të shkruaj në gjuhën shqipe dhe kështu kanë lindur ca libra me poezi për të cilët i jam shumë mirënjohës Fatmiri. Njëri prej tyre arriti të futet edhe në planprogramin për vitin e katërt të shkollave të mesme në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut.


Derisa po ndodhte kjo, në Meksikë u botua libri im i dytë "El tamaño del dolor" që u prit jashtëzakonisht bukur nga kritika dhe lexuesi meksikan. Arriti të futet nëpër biblioteka publike dhe po ashtu edhe në bibliotekat universitare në Meksikë dhe në disa universitete në SHBA. Në Kosovë më kishin "harruar" plotësisht. Edhe sot e kësaj dite në katedrën e Letërsisë dhe Gjuhës shqipe të Universitetit të Prishtinës, në lëndën e Letërsisë bashkëkohore shqipe nuk përmendet poezia ime. Kjo më dhimbte shumë, se Kosovën më duhej ta tërhiqja me vete kahdo që lëvizja në Meksikë. Shtu kësaj sfidën e përfuzueshme të përpjekjes që të shkruaj në gjuhën e Borhesit, Kortasarit, Markesit, Pasit, Nerudës, Valjeos, Huidobros, mos t'i rendis tashti gjeneratat spanjolle të 98'shit, 1914, 1927, 1936, 1940, 1950 etj.. T'i bie shkurt, pushova së shkruari në gjuhën shqipe, paj në Kosovë dhunohej liria e lëre më poezia e Xhevdet Bajrajt. Kjo vazhdoi për 10 vjet, më duhet të them që në Tiranë, në Globus R, poeti i njohur shqiptar, Petraq Risto e botoi "Shpuplimi i shqiponjës" që ishte një antologji personale, me poezitë e mia nga librat e botuar para

A. D: Z. Bajraj, ka mbi njëzet vjet që jeni larguar nga Kosova drejt Meksikës, çka do të thotë se një pjesë e madhe, në mos e gjithë krijimtaria juaj është mbrujtur larg atdheut. Besoj për këtë fakt, Kosova ndikon diqysh në letërsinë tuaj, apo jo? Ku shfaqet, ku tregohet ky ndikim?

Xh. B: Kurrë nuk e paskam menduar këtë fakt të dhimbshëm; është më se e vërtetë që pjesa më e madhe e krijimtarisë sime ka lindur larg atdheut. Sidoqoftë, atdheun e mbart me vete kahdo që shkoj, si një udhëtar që shpëtoi nga anija e përmbytur të cilit atdheu iu ka

kapur për njëren këmbë dhe tash jemi së bashku kudo, bashkë me të gjallët e me të vdekurit. Po ashtu vazhdojnë të vdesin aty njerëzit që i kam njohur dhe i kam dashur, lindin disa që kurrë nuk do t'i njoh. Lulëzojnë krimi i organizuar, korrupsioni, hajnia... rrënohet arsimi, shëndetësia, kultura (arti në përgjithësi). Ca vlera etike në të cilat dikur është investuar aq shumë, tani janë zhdukur dhe kjo më dhemb.

Pra, jetoj në vendlindjen e realizmit magjik dhe i mbart të gjitha plagët e trojeve shqiptare brenda vetes, e sidomos ato të Kosovës, dhe veçanërisht ato të Rahovecit. Nga ajo





luftës dhe nga librat e botuar në Tetovë, të shoqëruara me njëzet apo tridhjetë poezi të përkthyer nga gjuha spanjolle. Po ashtu, me insistimin e dramaturgut Jeton Neziraj, e përktheva një poemë time nga gjuha spanjolle, e shndërrova në monodramë, “Vrasja e mushkonjës”, e cila e fitoi çmimin *Katarina Josipi*, u përkthye në gjuhën serbe, angleze, gjermane dhe turke. Ideja më lindi natyrshëm sepse një regjisor argjentinas e pati adaptuar për teatër, shfaqje e cila u shfaq në Argjentinë dhe në Meksikë. Pra, pushova së shkruari në gjuhën shqipe deri në vitin 2014 apo 2015, derisa e takova në Meksiko Siti publicistin dhe shkrimtarin e njohur, Veton Surroi, një njeri për të cilin kisha dhe vazhdoj të kem shumë respekt. Ia dhurova ca tituj të librave në gjuhën spanjolle dhe u ndjeva keq kur i tregova që këta tituj nuk ekzistonin në gjuhën shqipe. Më kërkoi që ta pregatis një libër dhe t’ia dërgoj për *Botimet Koha*. Pastaj zonja Flaka Surroi u përkujdes për botimin e tij me titull “Copa ime e qiellit” dhe për botimin e librit të radhës “Lëngu i trëndafilave”. Ishte një bashkëpunim i jashtëzakonshëm me *Botimet Koha*. Bashkëpunimi me Koha-n është i rëndësishëm sepse m’u desh që krahas lexuesit meksikan, t’i kushtoja më shumë kujdes edhe lexuesit shqiptar. Pastaj librin e radhës, “Vitet që nuk e sollën pranverën” e botoi Klubi Letrar “De Rada” nga Ferizaj, që po ashtu ishte një bashkëpunim i shkëlqyeshëm me kryesinë e këtij klubi. Tash botoj në Shtëpinë botuese “Armagedoni”, me pronarin e saj e kam po ashtu një bashkëpunim që më bën të ndjehem autor i privilegjuar i kësaj shtëpie botuese. Shumica e këtyre librave u botuan në gjuhën shqipe dhe atë spanjolle. Me kalimin e kohës, si të shpjegohej, u zhduk rëndësia se në cilën gjuhë shkruaj dhe sivjet për herë të parë pas gjashtëmbëdhjetë vjetëve, “Armagedoni” do t’i botojë disa libra të mi të shkruar në gjuhën shqipe, natyrisht, në ta nuk do të mungojë edhe motivi meksikan.

E stërzgjata me përgjigje dhe i kërkoj ndjesë lexuesit, por për ta shpjeguar se si bashkëjetojnë dy gjuhë brenda një autori është më shumë çështje kulturore, individuale, që ka të bëjë me lidhjet e tyre, secilit veç e veç, me letërsinë.

A. D: Për të qëndruar edhe pak këtu, te lidhja me gjuhën: Ka raste kur shkrimtarë të ndryshëm, kujtoj këtu Mira Meksin, pasi shkruajnë në shqip, letërsinë e tyre e përkthejnë në një gjuhë tjetër. Ndërsa me ju ndodh e anasjellta, në fillim shkruani spanjisht e mandej, në shqip. Ky proces, më tepër se përkthim, a është rishkrim i poezisë? Dhe, a ndodh natyrshëm, apo i shtyrë nga kushedi ç’faktorë?

Kh. B: Nabokov e Brodski, edhe pse vinin nga një letërsi e madhe, kanë krijuar në gjuhë të huaj. Pol Celan, një nga poetët më të mëdhenj të poezisë universale, ka

qenë “i dënuar” që tërë jetën të shkruante në gjuhën e vrasësve të familjes së tij dhe të popullit të tij. Jeta di të bëjë kësi “shaka”. Është e gjatë lista e shkrimtarëve që kanë funksionuar shkëlqyeshëm në gjuhë të huaja. Ajo që di të them është se një krijues mund të shkruajë në gjuhën e tij amtare e pastaj ta përkthejë veten në gjuhë të huaj, por kjo nuk funksionon kështu. Të jem preciz, do të funksionojë, por si libër i përkthyer. Ta ilustroj këtë me një shembull konkret: po t’ia hiqim shënimin që është libër i përkthyer në gjuhën spanjolle romanit “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”, jo vetëm që në mënyrë automatike pushon magjia e këtij romani, por autorin do ta përceptonin si një të humbur në kohë. Sepse është një rrymë, një propozim estetik tashmë i tejkaluar. Natyrisht që elemente të saj do ta shoqërojnë prozën edhe për një kohë, por të krijosh do të thotë të ecësh përpara, do të thotë lëvizje, do të thotë të pushtosh hapësira, horizonte të reja, do të thotë të jesh i lirë. E kjo e fundit është më e rëndësishmja dhe një krijues i mirëfillt për asgjë në këtë botë nuk do ta sakrifikonte as një pëllëmbë të lirisë që e ka pushtuar vetë, qoftë edhe nëse në atë copë të lirisë autori shënon “rënie”. E futa brenda thojzave këtë sepse edhe rënia do të thotë fluturim. Liria është diçka përtej...

Shqipja dhe spanjishtja nuk janë uji e zjarri brenda meje, janë dy zjarre që bashkohen. Janë dy zogj në një distancë të shkurtër mes veti dhe... po ua dhuroj lexuesve tuaj një poezi të pabotuar në gjuhën shqipe, KËNGA E DASHURISË apo PARA SE TË FLUTURONIN ZOGJTË: Fluturimin e ka zbuluar zogu/ kur e ka dëgjuar një zog tjetër/ duke kënduar për dashurinë. Pra duhet të ndodh natyrshëm, e kjo ndodh kur bashkëjeton me një popull, me historinë e tij, traditën, muzikën, filmin, letërsinë. Kur ia njeh gëzimin, hidhërimin, plagët.

Dhe një këshillë për krijuesit e rinj, gratis: mos gënjeni, mos u përpiqni të mashtroni, as në gjuhën amtare e as në atë të huaj, se mendja mund të manipulohet, por shpirti assesi.

A. D: T’ju them të drejtën, pyetja e mëparshme lindi edhe për shkak të një tjetër fakti: Përveçse poet, jeni edhe përkthyes, spanjisht – shqip si dhe anasjelltas, ship – spanjisht. Mbi çka ndërtohet raporti i përkthimit të një tjetër shkrimtari dhe i përkthimit të vetes?

Kh. B: Kur përkthej, përpiqem t’i përmbahem origjinalit dhe të përpiqem ta bart në gjuhën tjetër sa më natyrshëm, e që të ndodhë kjo, nuk mjafton ta njohësh vetëm gjuhën, por duhet të ngrihesh në majë të gishtërinjve dhe të shohësh në shpirtin e një populli të tërë. Ta zëmë, Huan Rulfo është një shkrimtar brilant. Mirëpo, një argjentinas apo një spanjoll, edhe pse gjuhën spanjolle e ka gjuhë amtare, kurrë nuk do ta

kuptojë atë pa e kuptuar Meksikën, popullin meksikan dhe pa e kuptuar regjionin prej nga vjen Huan Rulfo. Kur e përkthej veten e kam shumë më lehtë, sepse e njoh popullin shqiptar dhe atë meksikan po ashtu. Unë jam pikë takimi i dy kulturave/gjuhëve dhe mbahem për atë pikë me thonjtë e zemrës. Thjesht, jam përkrahës i idesë që gjuha na humanizon. Kuptimi që bartin fjalët, mesazhi, emocioni na humanizon dhe jo loja kot e fjalëve, jo gëzhoja e tyre. Kjo e fundit në poezi prodhon vetëm zhurmë të maskuar.

A. D: Para se të flasim pak më konkretisht për poezinë tuaj, tanimë si shkrimtar, ndjej t’ju pyes nëse letërsia shqipe njihet ndopak në Meksikë e nëse po, ç’vend zë tablonë e përgjithshme letrare të atij vendi?

Kh. B: Për fat të keq, letërsia shqipe nuk njihet në Meksikë, trevat tona janë të rrethuara nga italianët, grekët dhe sllavët e jugut. Unë gjithandej ua dhuroj miqve të mi romanet e Kadaresë dhe të Kongolit dhe u flas studentëve për autorë të caktuar. E kam botuar në spanjisht edhe “Antologjinë e poezisë bashkëkohore shqiptare” të cilën ua dhuroj me shumë qejf studentëve të mi dhe e cila më shërben t’ua shpjegoj edhe rrethanat në të cilat është krijuar ajo. Por po ashtu, në orët e tjera gjatë semestrit u flas edhe për poezinë e popujve të tjerë. Shumë pak bëjnë shtetet tona për shpërndarjen e vlerave tona letrare. Them shumë pak, se mbase Ministritë për kulturë edhe i dedikojnë ca lekë për këtë punë, por ato përfundojnë në duart e sharlatanëve që tërë ditën qëndrojnë nën dritaret e asaj ministrie dhe krrokasin për ata lekë sikur janë duke vdekur urie. E krrokamat nuk mund t’ia shesësh botës, aq më keq, nuk i pranojnë ato qoftë edhe si dhurata.

A. D: “Jeta e poetit/ një pikë ujë/ që refuzon të derdhet në det/ avullohet/ dhe kthehet në tokë/ për ta ushqyer një bimë/ a për t’ia shuar etjen një fluturë/ që sapo braktisi rrobat e krimbit/ mbi varrin e ri...” Poezia nga ku është marrë kjo pjesë titullohet “Pika e ujit”. E nëse jeta e poetit është një pikë uji, po uji si plotni, pra si e tërë, është poezia? Në ç’mënyrë kjo “pikë” i përshtatet “së tërës”?

Kh. B: Është një pikë e ujit që përmban në vete të gjitha karakteristikat e pikave të tjera apo ujin si plotni. Ama kjo refuzon të derdhet në det, lexo të vdesë, kështu që rebelohet, shndërrohet në shi, pikë shiu dhe kthehet në tokë për ta ushqyer një bimë... e shoqëron njeriun edhe përtej vdekjes.

T’ia përkujtoj ndokujt që ka nevojë për shpjegim, nuk po flasim për ndonjë religjion të caktuar, por për poezi në të cilën edhe pse po flasim për një pikë uji, njeriu është në qendër të saj.

A. D: Në poezinë tuaj gjejmë të pranishëm edhe motivin e lirisë. Ama, ngjan sikur atë nuk e kërkon në vetvete, por synoni ta shpjegoni për të pasqyruar mungesën e saj. “E për ata që ende nuk e kuptojnë/ liri do të thotë/ kur krimbat shndërrohen në flutura/ majmuni në burrë të ri/ e burri të bëhet njeri”. Xhevdet, këto metamorfoza që ndodhin në liri, kur keni ndjerë të shfaqen për herë të parë në poezinë e Kosovës?

Kh. B: Eh, liria në Kosovë, apo në Ballkan në përgjithësi duket si një nocion abstrakt, kur e kemi parasysh që brenda një shtëpie, apartamenti apo kasolleje jetojnë dy gjenerata, breza, të mos them më shumë. E tash krahasojeni me kuptimin e lirisë së Nikos Kazancakisit që të ngjeth mishtë. Shiko, njeriu normal medoemos duhet të jetë i lirë, e të qenit gjallë, paj, të qenët gjallë sa për të qenë gjallë, mund ta shpie njeriun në një stad më të ulët se të çdo shtaze apo insekti të lirë. Në qendër të civilizimit oksidental qëndron individi, jo pa arsye, sepse kur dikush përpiqet ta gjunjëzojë, apo ta dhunojë një popull, do ta ketë shumë më vështirë ta bëjë këtë me secilin veç e veç. Nejse, ne si popull nuk e kemi këtë problem, ne me vite votojmë dhunuesit e lirisë sonë vullnetarisht. Kur jemi te liria e individit, disa e gjejnë lirinë në alkool, në drogë, disa në art, e disa në të gjitha këto së bashku. Ajo liri nuk gjendet në nivelin e artit mesatar, por në kufinj të një propozimi estetik që mbretëron brenda epokës në të cilën jeton krijuesi. E po ai krijues, duhet ta përshkojë mespërmasë atë bërthamë, e jo të ndalet aty.

Kam frikë se poezia e Kosovës është në krizë të thellë dhe jo vetëm poezia, por edhe gjinitë e tjera letrare. Ajo që mbahet për këmbën time ka vetëm ca emra të përveçëm krijuesish, të tjerët, shumica e tyre, për fat të keq, me apo pa vetëdije, i thurin lavde injorancës. Nëse do të kishin kontakt me poezinë e indianëve të Amerikës Latine, do të duheshin të turpëroheshin. I përmenda banorët e vjetër të Amerikës dhe poezinë e tyre qoftë edhe këtë aktuale, që na përkujtojnë zgjuarsinë e të parëve tonë, fëmijërinë e njerëzimit dhe mënyrën e tyre të pafajshme për ta parë, për ta shijuar botën dhe për t'i emëruar gjërat që i kanë rrethuar. Poeti duhet të ketë trashëguar diçka nga ai sinqeritet. Por të paturpët nuk e njohin këtë ndjenjë, prandaj edhe qëndrojnë poshtë dritareve të Ministrisë për Kulturë apo institucioneve ndërkombëtare dhe presin t'u bie ca "ushqim" nga ato dritare. Kjo ta lë përshtypjen e gabuar që shteti vepron kundër artit. E kjo është një e vërtetë e mangët. Por kjo është temë tjetër, ndërsa unë po ngutem t'iu përgjigjem pyetjeve tuaja në momentin e fundit.

A.D: Po poezia juaj në përgjithësi, pa u ndalur në raste të veçanta, në ndërlidhjen e krijuar me lirinë, a është manifest i saj, kërkim i pareshtur drejt zbulimit të saj apo gjësend tjetër?

Xh. B: Natyrisht, jetën, lirinë, njeriu mendon që i njeh, që i di ato, por në të vërtetë shumë pak, apo të mos them asgjë nuk di për to. Edhe kur njëra sakrifikohet për tjetrën, jeta për lirinë apo liria për jetën, sërish kam frikë që nuk di për to (respekt të rënëve në të gjitha luftrat për ta mbrojtur atë që e njohim si liri). Arti e plotëson këtë, e krijon këtë lidhje, qoftë bile duke i përshkruar të dy anët e rrugës që shpie në varr, pra nga dita e lindjes deri në ditën e vdekjes. Shto kësaj barrën e ëmbël të dashurisë, apo atë të hidhurën, mungesën e saj (dashurisë). Kazancakis edhe dashurinë e merr si pengesë për ta arritur lirinë, prandaj edhe thashë që liria e tij të ngjeth mishtë. Sidoqoftë, liria krijuese, poezia, është si uji i dëgjueshëm, i disiplinuar që i lidh dy brigje, dy a më shumë ishuj, dy a më shumë zemra, mes veti. Nëse në poezi nuk ndodh kjo, atëherë ajo thjesht do të ishte e barabartë me një masturbim estetik.

A.D: “Kam kohë që jam i vdekur/ por kam përshtypjen/ se jam duke i ëndërruar këto që i shkruaj”. Nëse vërtetë po ëndërrohen këto që shkruani, kur të zgjoheni, si do ta kujtoni këtë ëndërr?

Xh.B: Nganjëherë duhet të vdesim që të mund të këndojmë (të shkruajmë poezi për jetën), ndonjëherë, apo shumë shpesh, e bëjmë këtë duke vdekur, figurativisht po shprehem, dhe nuk po flas për autorët që ka kohë që kanë vdekur e ne i lexojmë me ëndje, apo një numër të konsiderueshëm të tyre, i refuzojmë me ëndje. Po ashtu, nganjëherë më duket se i ngjaj një heroi të njërës nga poezitë e mia, që ngrihet nga varri dhe shkon në kërkim të një atdheu tjetër për të vdekur për të, e ku nuk do të abuzohej me lirinë, kështu që këndon brenda një varri dhe mbase ka kush e dëgjon këngën e një të vdekuri.

A. D: “Muza më çmend/ thotë se/ poeti nuk mund të fle/ pa e zbutur tokën e egër/ pa u kthyer në atdhe”. Kjo poezi, vërtetë më ka tronditur! Por njëkohësisht, më ka bërë të mendoj: poeti e mbart apo e krijon atdheun? Ju, si mendoni?

Xh. B: E krijon dhe e mbart. Herë unë e ngreh zhagas, herë ai më shtyn përpara. Edhe po të kthehesha në Kosovë, kjo nuk do të ndryshonte, sepse një lloj atdheu tash e kam Meksikën. Para se ta ndjeja Meksikën kështu, mendoja që jam si një pemë që e kanë sjellë në një pjesë të botës me kushte shumë të volitshme, por që ajo pemë është krijuar për Kosovë dhe që nuk mund të çelë lule apo të jep fruta larg Kosovës. Pas tërë këtyre viteve në Meksikë, mbase edhe po të kthehesha në Kosovë a Shqipëri, do të më ndiqte e njëjta ndjenjë, se më është kapur diçka për njërën këmbë. Si duket për momentin, qenkam lindur që të këndoj shumë larg Kosovës.

A. D: Një tjetër motiv, mjaft i rëndësishëm, veçanërisht në *Copa ime e qiellit*, është edhe gruaja. Në një poezi me këtë titull, pra *Gruaja*, shkruani “*Sa e dhimbshme do të ishte të jetohet një jetë e tërë/ dhe një herë/ të paktën një herë/ të mos i përkushtohet një poezi/ një gruajë*”. Edhe unë ndaj të njëjtin mendim, por për arsye që vështirë t'i kuptoj, ndaj vargje të

tilla më ngjan sikur po më lexojnë, jo sikur po i lexoj. Prandaj, dua t'ju pyes ju, thjeshtë, pse? Pse do të ishte kaq e dhimbshme?

Xh. B: Sepse gruaja bën që të të çelë lulja e ballit, të të lëvizë kapaku i kresë, të të skuqen mollëzat e faqeve, të të këndojë zogu brenda kafazit të kraharorit, të të fluturojnë zogjtë e këmbëve ose të të dridhen lidhëset e këpucëve. Kjo është veç një pjesë e gjërave që do të mund t'i ndodhnin njeriut. Nejse, ishte një shaka me një gjysmë poezie. Kështu e kam më lehtë të përgjigjem, se të them për shembull që një njeri që kurrë nuk ka qenë i nxitur nga një grua për ta shkruar një poezi, nuk është një njeri komplet. (Respekt për homoseksualët!).

A. D: Ju keni shkruar poezi për nënën, babain, vëllain, nipin... Në ç'mënyrë ngërthehet në një krijim marrëdhënia e krijuesit me njerëzit e tjerë, qofshin ata familjarë, miq, të njohur a të panjohur?

Xh. B: Këto poezi janë më shumë klithje, klithjet e fundit të individit brenda rrethanave në të cilat jeton. Thirrje për t'u zgjuar nga gjumi. Shfaqen në to problemet sociale me të cilat ballafaqohet Kosova, përcillen mesazhe



politike, e në të vërtetë kudo është një dashuri e madhe për njeriun, për të afërmin. Është një nga mënyrat për të komunikuar me lexuesin shqiptar, sidoqoftë, edhe në gjuhën spanjolle u arrijnë njerëzve në zemër.

A.D: Poezitë e librit tuaj “Kafe me nënën” paraqesin ndjenjën e një dhimbjeje të sinqertë për të pashmangshmen: vdekjen. Mes të tjerash, aty keni një poezi me titull “Të vdekurit nuk janë larg”. Si mendoni, çfarë na ndan nga të vdekurit?

Xh. B: Ne nga ata na ndan një frymëmarrje, një e rrahur zemre a qerpiku. Në të vërtetë ata jetojnë me ne, na detyrojnë të bëhemi më të mirë, më të këqinj, na i mbajnë të hapura dyert e jetës e të lirisë, nganjëherë nuk na lënë të flemë. Na detyrojnë apo na ndihmojnë të dashurojmë. Na mësojnë të gjitha, por zakonisht nuk kemi veshë t'i dëgjojmë. Ashtu si nuk kemi veshë t'i dëgjojmë kafshët e egra dhe të buta, yjet, muzikën e tyre, fijet e barit... E ato, dua të besoj se na dëgjojnë.

A. D: Po poezia, a e zgjeron apo e ngushton këtë largësi?

Xh. B: Brenda saj (poezisë) koha rrjedh ndryshe dhe nuk matet dot as me orë alafanga as me atë allaturke. Prandaj në poezi asgjë nuk na ndan nga ata, përkundrazi, ajo na lidh më shumë. Poezia e ngushton aq shumë largësinë, sa që nganjëherë është vështirë të dallojmë se kush është gjallë e kush i vdekur. Poezia është një dritare drejt së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes. Të shkruash do të thotë të shpjegosh vetveten. Të jesh i vetëdijshëm se gjërat që i sheh, qoftë si i verbëri që i sheh me prekje të dorës, të shohin edhe ato ty.

A. D: Në titujt e librave të tu, lexojmë se përveç nënës, keni edhe Rahovecin (*Ca kokrra rrushi të Rahovecit*). Është interesante, pasi vetëm në këto raste, vërehet qartë një konceptim konkret i titullit. Ndaj, vetvetiu më lind pyetja: Në jetën tuaj letrare, nëna dhe vendlindja ç'rol kanë? A ekziston një lidhje gati transhendente mes tyre?

Xh. B: Pajtohem, bile kështu është për mua. Njerëzit dhe vendet lidhen fuqishëm në mua, apo më mirë ta them ndryshe, unë lidhem me njerëz dhe me vende fuqishëm, pothuaj në mënyrë të pandashme. Dhe kur ndodh të na ndajnë e ndjej se si më hiqet një copë mishi, pa anestezi. Kur shkoj në Rahovec, pjesën më të madhe të kohës e kaloj me shokët e fëmijërisë. Është një ndjenjë e papërshkrueshme. Sapo të ulet aeroplani në aeroportin e Rinasit apo në Prishtinë, unë shndërrohem në fëmijë, pas një muaji, po në të njëjtët aeroporte, unë ndjehem plak me disa qindra vjet jetë.

Mund të jem i lumtur në Sarandë, Kavajë, Kukës a Tetovë, janë njerëzit, rruga, qyteti që ma japin këtë ndjesi dhe pse jo, edhe kafenetë e qytetit. Nuk mund të jem i lumtur në Shqipëri vetëm në vitin 1997.

A. D: Xhevdet, përveç poezisë, ju jeni gjithashtu protagonist në filmin “Aro Tolbukhin - Në mendjen e vrasësit” (Aro Tolbukhin – En la mente del asesino), të regjisorit spanjoll Agustín Villaronga, film ky që ka qenë fitues i disa çmimeve ndërkombëtare. Çfarë ju motivoi për t'u marrë edhe me një tjetër formë të artit, përveç letërsisë?

Xh. B: E dua filmin; erdhi regjisori dhe më ftoi të jem pjesë e projektit. U habita shumë, por e kisha kureshtjen e fëmijës, thashë ta provoj edhe këtë. Ishte një përvojë fantastike me ekipin e filmit, sidomos më pëlqente ajo që ndodhte prapa skenës. Kur e shikova filmin për herë të parë, e vëreja se çfarë do të thotë të punosh brenda një ekipi. “Poeti” në këtë rast ishte regjisori, në të vërtetë kishte goxha poetë aty e unë nuk isha as Robert de Niro e as Al Paçino.

A. D: Ndërkohë, ju jeni profesor në “Akademinë e Krijimtarisë Letrare” në “Universidad Autónoma de la Ciudad de México”. Në Shqipëri, por besoj se edhe në Kosovë, një Akademi e tillë mungon. Ç'mësim, nga formimi pedagogjik, por edhe ai letrar, mendoni se mund të ndani me krijuesit që e lexuan këtë bisedë?

Xh. B: Studentëve iu flas për atë se e kanë një rast të mirë të mos e kalojnë jetën në gjumë, se gjatë rrugës së jetës mund të mbështeten në poezinë dhe se ajo viza në mes të datës së lindjes dhe të vdekjes mbi gurin e varrit të tyre do të paraqesë një aventurë të jashtëzakonshme për vizitorët e varrezës apo të bibliotekës. Se e kanë një rast të mirë t'u flasin stërnipave me shpirtin e një epoqe, për autorin personalisht dhe për njerëzimin. U them ta gjejnë një shpirt binjak në një kohë tjetër, në një kontinent tjetër. Se poezia është përgjigjja më e pastër e qenies njerëzore në pyetjet thelbësore në lidhje me jetën, dashurinë dhe vdekjen. Pastaj ua lexoj disa poezi, si për shembull *Arti poetik* të H. L. Borhesit, *Arti poetik* të V. Huidobros, *Një këngë për fundin e botës* të Ç. Milloshit apo *Itakën* e K. Kavafis apo këtë:

Ç'është poezia? - thua ndërsa e ngulit
në bebëzën time të syrit bebëzen e kaltër tënde.
Ç'është poezia! Dhe ti më bën këtë pyetje?
Poezia... je ti.
Gustavo Adolfo Beker (Gustavo Adolfo Bécquer)

A. D: Faleminderit, për zemërsisht!

Xh. B: Falemnderit juve, ishte një kënaqësi për mua.

Fillimet e ideologjisë albaniste në shek. XVIII: Pal Maria Parrino dhe vepra e tij

Matteo Mandala

Në librin *Gjurmime filologjike për letërsinë e vjetër arbëreshe* (Çabej, 2006) përfshiva një studim të përmbledhur në shqipe mbi jetën dhe veprën e Pal Maria Parrinos, tekstin e plotë të të cilit e kisha botuar italisht një vit më parë me rastin e përvjetorit të vdekjes së këtij dijetari arbëresh (1765-2005). Në këtë portret të shkurtër jo vetëm do të përkujtoj 310-vjetorin e lindjes së tij (1711-2021), por do të përfitoj nga rasti për të vënë në dijeni lexuesit e revistës *ExLibris* me realitetin e rëndësishëm kulturor arbëresh të shekullit XVIII dhe me kontributin e larmishëm që një aradhe intelektualësh, pothuaj të gjithë priftërinj arbëreshë nga Sicilia, u dhanë çështjeve të identitetit kulturor mbarëshqiptar në një fazë historike që paraprin, duke e përgatitur atë ideologjikisht, periudhën e Rilindjes kombëtare. Falë angazhimit të këtyre studiuesve të palodhshëm lindi lëvizja që, në pajtim të plotë me simotrat që përshkonin kontinentin evropian, shpiku ide risore, zbatoi metoda moderne – që i paharrueshmi prof. Çabej do t'i quante “globale” –, themeloi bazat e kulturës shkencore të albanologjisë që me kalimin e kohës do të fitonte statusin e sotëm epistemologjik, pra do të bëhej një shkencë ndërdisiplinore në hullinë e së cilës kërkimet historike do të bashkëvepronin me ato antropologjike, studimet gjuhësore me prodhimtarinë letrare. Në krye të këtij revolucioni kopernikan ishte vizionari i madh arbëresh, At Gjergj Guzzetta, i cili përveç meritave të shumta, pati largpamësinë të afronte të rinjtë më të talentuar arbëreshë dhe


t'u ofronte atyre mjetet e duhura (institute, libra, mësues, karrierë) për të arritur qëllimin e krijimit të një tradite të shëndoshë intelektuale. Në veprën e tij *De Albanensium Italiae rite excolendis*, At Guzzetta ravijëzoi në vija të përgjithshme pikat kryesore të problemit të identitetit arbëresh, duke u dhënë në fakt brezave që e pasuan shtysën t'i çonin më tutje kërkimet “albanologjike”, deri në realizimin e projektit madhor të ndërtimit të ngrehinës mbarëshqiptare të kulturës që sot, jo pa mburrje, e quajmë “kombëtare”. “Gurin themeltar në ndërtuesen e një kulture shqiptare” – siç do të shprehej Eqrem Çabej – arbëreshët e vunë pikërisht gjatë shekullit të iluminizmit, falë brezave që patën fatin të ndiqnin gjurmët e At Guzzettës. Ia vlen të kujtojmë në veçanti dy nga bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë dhe njëkohësisht dy nga mendjet më të ndritura të mesit e shekullit XVIII.

I pari ishte Pietro D'Andrea, autor i veprës së vëllimshme me titull *Trattato di filosofia morale* që sot e kësaj dite ruhet dorëshkrim në arkivin e Seminarit arbëresh që sot ndodhet në Horën e Arbëreshëve. Vepra përmban përshkrime të hollësishme të mendimeve të filozofëve që janë marrë me aspektet e filozofisë morale qysh nga antikiteti grek deri te periudha që paraprin shfaqjen e iluminizmit. Në këtë vepër të hartuar për studentët e Seminarit gjenin jehonë edhe diskutimet mbi marrëdhëniet ndërfetare katolike-ortodokse që, në kohën kur shkruante D'Andrea, pra në çerekun e parë të shekullit XVIII, kalonin një fazë




problematike që lidhet me vendimet e Papës Benedikti i XIV kundër komuniteteve fetare, si ato arbëreshe, që ndiqnin ritin lindor në Itali dhe të cilat për këtë arsye kritikoheshin ashpër dhe ndëshkoheshin nga autoritetet katolike vendase. Çështja ishte themelore dhe nuk qe aspak rastësor fakti që pikërisht D'Andrea do t'i bashkohej përpjekjeve të Guzzettës për t'ua bërë të qartë autoriteteve të Kishës Katolike dhe priftërinjve të saj se arbëreshët nuk i përkisnin ortodoksisë “heretike”, por përbënin një komunitet katolik që ndiqte ritet lindore. Shqiptar me origjinë nga krahina e Himarës, D'Andrea mbërriti në Itali shumë kohë më përpara se të organizohej i ashtuquajti *Regiment Mbretëror Maqedonas*, i cili, siç dihet, ishte i formuar nga ushtarë shqiptarë të rekrutuar në Himarë. Qysh nga viti 1712 atë e gjejmë në Palermo, famullitar të *Kishës së Shën Kollit të Grekëve*. Pikërisht pranë kësaj kishe Guzzetta do të ndërtonte në vitin 1734 Seminarin e lartpërmendur, duke i besuar mikut të tij D'Andrea rolin e Rektorit të parë. Pesë vjet më vonë, pikërisht në vitin 1739, në këtë funksion D'Andrea-n e zëvendësoi nxënësi i preferuar i At Guzzettës, i riu Pal Maria Parrino, i cili ndoshta vetëm për arsye moshe nuk u emërua Rektor që nga themelimi i Seminarit.


Pasi familja nuk mundi ta dërgonte në Romë për të ndjekur studimet pranë Kolegjit Grek, në vitin 1725 Parrino u miratua nxënës në institutin *Oratorio Filippino* të themeluar në Horë nga At Guzzetta (1716), i cili qysh nga ai vit do të kujdesej personalisht për formimin e katërmëdhjetëvjeçarit arbëresh nga Palazzo Adriano. Në periudhën e formimit të tij rinor Parrino do të studionte veçanërisht shkencat teologjike, retorikën dhe filozofinë morale; por përkushtimin më të madh do t'ua rezervonte kërkimeve historike, nga të cilat



Pal M. Parrino, *De studios* (1738), Arkivi i Seminarit Greko-Arbëresh, f. 1r



Pal M. Parrino, *De perpetua drsh. v3* (1761), Arkivi i Seminarit Greko-Arbëresh, f. 9r



Pal M. Parrino, *In septem drsh. v1* (1761), Arkivi i Seminarit Greko-Arbëresh, f. 9r

Vijon nga faqja 5

Fillimet e ideologjisë albaniste në shek. XVIII: Pal Maria Parrino dhe vepra e tij


nuk u nda kurrë gjatë jetës së tij. Në kuadrin e kohës, befasuese është edhe vëmendja e madhe që i kushtoi studimit të gjuhëve te huaja: jo vetëm të atyre klasike – greqishtes dhe latinishtes, të cilën ai do ta përdorte shkëlqyeshëm për të shkruar disertacionet zyrtare dhe veprat e tij kryesore – por sidomos atyre bashkëkohore: së pari frëngjishten, të cilën ai e dinte në mënyrë të përsosur, pastaj anglishten dhe, sidomos, italishten “letrare”, gjuhë kjo e fundit që Parrino, ndryshe nga shumë arbëreshë të tjerë, e zotëronte me kompetencë stilistike dhe aftësi retorike të veçanta.

Veprimtaria e Parrinos do të fillonte herët. Studimin e parë e hartoi në prag të emërimit në detyrën e Rektorit, pra në vitin 1738. Teksti në latinisht na mbërriti në dorëshkrim me titull *De studiis necessariis ad recte instituendos Siculo Albanensis Collegii Candidatos. Oratio ad rerum albanensium studiosos (Mbi studimet e nevojshme për një formim korrekt të studentëve të Kolegjit Shqiptar të Sicilisë. Fjalim për studiuesit e gjërave shqiptare)*. I konceptuar në formën e një Oratio, fjalimi solemni i Parrinos synonte t’u përshkruante studentëve të Seminarit dhe gjithë atyre që dëshironin të merreshin shkencërisht me “rerum albanensium”, fushat kryesore që duhej të studionin për të kuptuar thelbin historiko-kulturor-fetar të qytetërimit dhe të identitetit të shqiptarëve. Një qytetërim dhe një identitet që duhej dalluar qartë nga ai grek falë tipareve historike, fetare, gjuhësore dhe antropologjike të ndryshme, sidomos në kushtet kur arbëreshët ngatërroheshin rëndom me grekët. Detyrimi kryesor i studentëve arbëreshë, pra, ishte të njihnin historinë e tyre kombëtare, traditat e lashta të krishtera të periudhës para-skizmës, përvojën heroike të Gjergj Kastriotit [«*eorum Principe Georgio Castriota, fortissimo Christi Atleti, celeberrimo post hominum memoriam duce, altero Alexandro Magno, tot victorias de Turcis christiani nominis hostibus reportarunt, ut indefessi religionis nostrae defensores merito dicti sint, et Propugnatores*»], përpjekjen për të vërtetuar sa të ndryshëm nga grekët dhe sa larg gabimeve të tyre heretike janë shqiptarët për nga “fisi, gjuha dhe zakonet” [«*Et quoniam ignarum vulgus cum nos Græcos habeat, græcorum quoque errorum participes facit, ostendendum esset, quæ hos inter et albanos genere, lingua, moribus distantia sit*»].


De studiis ishte premisa e programit kërkimor, realizimit të të cilit Parrino do t’i kushtonte tërë jetën duke shkruar një varg veprash që fatkeqësisht mbetën të pabotuara por, siç do ta shohim, jo të panjohura nga rrethet intelektuale arbëreshe, si nga ato siciliane edhe nga ato jashtë Ishullit. Një përpjekje e ndërmjetme do të ishte hartimi i veprës *Perpetua Albanensis Ecclesiae consensionis cum Romana omnium Matre et Magistra libri VII. (Opus Historico-theologicum in duas partes divisum; quarum altera fidei disciplinæ, altera utriusque Ecclesiae consensionem ostendit. Ad usum Seminarij Siculo-Albani)*. Titulli dhe nëntitulli janë dy tregues mjaft interesantë për të rindërtuar kontekstin dhe qëllimin e veprës: titulli i bënte jehonë veprës *De ecclesiae occidentalis atque orientalis perpetua consensione*, që teologu grek Leone Allacci, nxënës i Kolegjit Grek në Romë, botoi në vitin 1648 për të kundërshtuar pretendimet ortodokse dhe, njëkohësisht, për t’i afuar qëndrimet parimore teologjike mbi të cilat, nga njëra anë, në mesin e shek. XVII ende rrënjosheshin mosmarrëveshjet fetare dhe, nga ana tjetër, në mesin e shek. XVIII vazhdonin të ushqeheshin polemikat katolike kundër riteve lindore që ndiqnin pakicat fetare ballkanike të vendosura në Itali, ndër të cilat edhe ato arbëreshe. Kuptohet lehtë që zgjedhja e titullit nga ana e Parrinos nuk ishte e rastit, por synonte të vërtetonte një vijimësi ideologjike me mendimin e Allacit, personaliteti i të cilit gëzonte respekt të pakundërshtueshëm në ambientet e Vatikanit. Nëntitulli tregon shprehimisht që vepra ishte një doracak në shërbim të studentëve të Seminarit, pra autori nuk pretendonte, së paku në këtë fazë, ta botonte. Mirëpo, qysh nga viti 1750 kjo vepër ishte bërë e njohur edhe në Romë, siç vërtetojnë materialet e gjetura në Arkivin e Kongregatës *De Propaganda Fide* dhe ndoshta në mjediset zyrtare të Vatikanit kishte lindur ideja që ajo të botohej. Propozimi i botimit dështoi kur Parrino e pa të udhës të perfeksiononte strukturën e përgjithshme dhe sidomos kur vendosi të plotësonte këndvështrimin historiko-teologjik duke ndjekur rrugën kërkimore të çelur nga At Guzzetta me përfshirjen e çështjeve antropologjike dhe gjuhësore. Gjatë pesëmbëdhjetëvjeçarit 1750-1765, pra pas vdekjes së Mentorit të tij, Parrino shkruan veprën e

tij kryesore me titull *In septem perpetuæ consensionis libros Albanensis Ecclesiae cum Romana omnium Mater et Magistra* [Marrëveshja e përhershme midis Kishës Shqiptare me atë Romake Nënë dhe Mësuese në shtatë libra], e cila, siç do ta shohim më poshtë, gëzon lidhje shumë të ngushta me veprën që e paraprin, pra me *De Perpetua*.


Sot kemi në dorë disa variante të veprave të Parrinos, të gjitha në latinisht, që tregojnë sa e gjatë dhe e lodhshme ka qenë puna kërkimore-studimore që u parapriu. Pa u ndalur në aspektet më të imta filologjike, për të cilat e ftoj lexuesin t’i referohet studimit tim të vitit 2005-06, përpjekja gjigante e Parrinos mund të përmbledhet në tri faza që shtrihen gjatë viteve 1735-1765 dhe që përcaktojnë evolucionin e mendimit të tij teologjik në lidhje me shkallëzimin e kërkimeve në fushën e historisë: a) Faza e para karakterizohet nga disa punime në të cilat, përveç shtjellimeve për të përvijuar pozicionimin didaktiko-pedagogjik të Seminarit dhe për të treguar dobinë e studimit të historisë dhe të gjuhëve greke dhe latine, shquhen përpjekjet për të mbrojtur ato pika të disiplinës orientale që sulmoheshin nga klerikët e ritit latin. b) Faza e dytë rrok dekadën 1746-1756 dhe nxjerr në spikamë përpjekjen e Parrinos për të mbledhur materiale të dobishme për historinë e bashkësive arbëreshe të Italisë, veçanërisht të Sicilisë dhe për të hartuar një vepër (*De perpetua*) ku të shtjellonte në rrafshin historiko-teologjik unitetin mes Kishës Latine dhe asaj Lindore. c) Faza e tretë kap periudhën 1757-1765 dhe karakterizohet prej dy momenteve të dallueshme nga njëri-tjetri: i pari karakterizohet nga përpjekjet e Parrinos për të përpunuar veprën *De perpetua* dhe për ta plotësuar atë nën dritën e projektit të tij të ri shkencor. Ky i fundit parashikonte përpunimin e një veprë të artikuluar në dy pjesë, nga të cilat e dyta ishte pikërisht *De perpetua* dhe e para ishte një vepër që duhej shkruar *ex-novo* mbi bazën e reflektimeve të Guzzettës. Vepra që Parrino kishte menduar si pjesë e parë e projektit të tij të madh ishte në fakt *In septem*, në të cilën Parrino jo vetëm derdhi njohuritë e grumbulluara në rrjedhën e kërkimeve të tij të gjata e të lodhshme, por ia doli t’i jepte një fizionomi historiko-kulturore identitetit të pakicës arbëreshe në Itali. Kjo fizionomi nuk qe dokumentuar me kaq rigorozitet kurrë më parë. Ai arriti gjithashtu që për herë të parë të përdorte një metodë kërkimi “globale”, duke futur shqyrtimin jo vetëm të veçantive religjioze, por, mbi të gjitha, edhe të prejardhjes e të zhvillimeve historike, të gjuhës, të zakoneve, të traditave, pra të kulturës, ose të asaj tërësie që Guzzetta, në përputhje me prirjet ideologjike bashkëkohëse europiane, guxoi të quante “kombi shqiptar”.



Pal M. Parrino, *In septem drsh. β1* (1761), Arkivi i Seminarit Greko-Arbëresh, f. 8r



Pal M. Parrino, *De perpetua drsh. β2* (1761), Arkivi i Seminarit Greko-Arbëresh, f. 8r



Pal M. Parrino, *In septem drsh. α* (1765), Arkivi i Seminarit Greko-Arbëresh, *Prolegomena*, f. 1r

Violeta Volumi, ndonëse është diplomuar në fizikë, lëndë të cilën e dha gjatë gjithë jetës, në prag të daljes në pension, në vitin 2015, vendosi të krijojë audiolibrin e parë shqip.

Audiolibri më perkund me zërin e malluar të nënës sime

A.D.: Prof. Violeta, bisedat me ju janë përherë kënaqësi! Pasioni që keni për librin është aq i madh, saqë prej disa vitesh, tanimë, keni vendosur t'i dedikoni kohën dhe përkushtimin tuaj gati të përditshëm nëpërmjet një platforme pak të njohur në Shqipëri sikurse është audiolibri. Nga ju lindi fillimisht kjo ide?

V.V.: I dashur Andreas, së pari ju falënderoj për këtë intervistë që më rezervoni në gazetën "ExLibris", një gazetë elitare në art e kulturë. Për mua, nëse përralla më sjell në mend zërin e gjyshes, audiolibri më perkund me zërin e malluar të nënës sime, të librave të parë që më bënë dhuratë motrat e vëllezërit. Pastaj më çon në ditët e netët e vetmuara e të vështira në spital, ku ëndërroja që dikush të lexonte për mua ndonjë libër, më sjell në mendje miken time të gjimnazit, që sot nuk mund të lexojë për arsye shikimi. I kisha shumë borxhe letërsisë.

Vite e vite të tëra, më është gjetur pranë në momente dëshpërimi e gëzimi. Gjashtë vite të shkuara, nipi më solli një dhuratë që ma ndryshoi jetën: një iPad ku kishte shkarkuar për mua libra në format pdf dhe audiolibra në format mp3. Kërkova nëse kishte në shqip ndonjë faqe të tillë. Por jo, e vetmja gjë që gjeta ishte një podcast në Australi.

Ajo ishte shkëndija e parë, e që prej asaj dite nuk gjeta rehati, derisa me ndihmën e nipit tjetër, sipas modeleve më të mira, arrita të krijoj website-in <http://www.volumiaudiolibra.com/>, një platformë e shërbim që ofrohet falas sipas motos: Librat do të duhej të ishin falas.

Zgjedhja emrin e familjes volumiaudiolibra sepse ka qenë kontribut i gjithë familjes dhe ish nxënësve të mia, që në këtë risi, u bënë mesueset e mia.

Vitin që shkoi, kishim edhe përvjetorin e pestë të faqes së audiolibrit në gjuhën shqipe, faqe që ka filluar aktivitetin e saj para 5 vitesh, në nëntor 2015.

A.D.: Po në vijim, si u pasurua audiolibri? Kush ishin lexuesit e parë dhe kush janë lexuesit e tanishëm? Po veprat kryesore të publikuara, cilat janë?

V.V.: Sikurse e përmenda pak më parë, unë ia kisha borxh librit kënaqësitë që më ka falur, ndaj mendimi i parë ishte të kthej në audiolibra veprat kryesore që kanë ndikuar në formimin tim, e më pas, të ndjek trendin e audiolibrave në botë; nga ato klasikë, në ato bashkëkohorë në të gjitha gjinitë: romane, novela, tregime, poezi, esse apo edhe libra historikë, etj., etj.. Përsa i përket lexuesve, ato kanë qenë e janë lexues vullnetarë.

Dy janë familjet e mëdha të lexuesve: lexues të familjes sime dhe lexues nga familja e dytë, e dashur për çdo mësues, ajo e nxënësve dhe ish nxënësve. Ndër to keni qenë edhe ju, që keni kontribuar jo vetëm me lexim të tregimeve, por edhe me përkthimet tuaja.

Po përmend disa nga autorët e përzgjedhur si pjesë e galerisë së audiolibrit: Cronin, Camus, Ryunosuke, Balzac, James Barry, Bakalli, Borges, Bulgakov, Buzzati, Byron, Jung, Cehov, Dickens, Kollodi, Roald Dahl, Dante Alighieri, Grazia Deledda, De Amicis, Dostojevski, Dushi, Elsa Morante, Remark, Koliqi, Antoine de Saint Exupery, Kongoli, Faulkner, Fishta, Fitzgerald, Flober, Nadine Gordimer, Galsworthy, Goethe, Gorky, D'Annunzio, Verga, Maupassant, Sienkiewicz, Heminguej, Hermann Hesse, Hugo, Borges, Andric, Sartre, James Joyce, Jules Verne, Franz Kafka, Khaled Hosseini, Kavabata, Kierkegaard, Krauss, Kuprin, Lamartine, Lazri, London, Sepulveda, Proust, Marquez, Marin Barleti, Martin Camaj, Migjeni, Mullisi, Temali, Kundera, Mjeda, Sparks, O. Henry, Oliver Sacks, Orwell, Ovidi, Perrault, Pirandelo, Edgar Allan Poe, Pushkin, Carver, Rilke, Singer, Tolstoy, Tomas Mann, Turgeniev, Mark Twain, Herbert Wells, Vëllezërit Grimm, Oskar Wilde, Virginia Woolf, Stefan Cvajg, Zef Zorba, etj.. Kjo për të treguar kujdesin për t'i sjellë dëgjuesit ajkën e letërsisë. Ndjesë që nuk arrij t'i përmend të gjithë.

A.D.: Sot, në fillimin e vitit 2021, sa materiale audio numërohen në faqen e internetit <http://www.volumiaudiolibra.com>?

V.V.: Tituj librash të plotë janë 127. Numërohen rreth 29 romane, 43 novela, 213 tregime, 131 përralla, 143 poezi dhe poema, 110 esse, etj.. Të regjistruar në faqen zyrtare të audiolibrit janë 2096 përdorues, 836 mijë dëgjime.

Ndërsa në youtube <https://www.youtube.com/c/VioletaVolumi> janë 1230 përdorues të regjistruar. Në faqen e mësipërme janë hedhur 730 video të audiolibrit shqip, 352 mijë dëgjime. Në total në këto dy kanale kryesore janë 1 milion e 188 mijë dëgjime librash, pa llogaritur ato të librave që kam qenë e detyruar të heq për arsye copyright-i.

Mendoj se më e preferuara për dëgjuesit është kategoria e tregimeve të shkurtra, prandaj kohët e fundit, edhe jam fokusuar në këtë kategori.

A.D.: Ju personalisht i rregulloni, i sistemoni dhe i publikoni materialet vetë në portalin e audiolibrit. Të kryhet vetëm nga një person, ngjan punë e mundimshme... Apo e kam gabim?

V.V.: Në fakt, është një punë pa mbarim, në kuptimin që, gjithnjë kur përfundon do të doje ta kishe bërë edhe më mirë. Por koha është ajo që është: të duhet ta ndash mes përzgjedhjes së materialit, regjistrimit, pastrimit të audios, përgatitjes së kopertinës, të linkut të autorit, hedhjes në faqe, konvertimit në youtube, pastaj divulgimit në Facebook, Twitter, LinkedIn, në mënyrë që t'i shkojë personave të interesuar. Në fillim e kam patur pak të vështirë t'i mësoj tërë këto procese e programe, gjë që ndjehet në cilësinë e audiove të para, të cilat, shpresoj të kem mundësinë t'i bëj sërish më mirë. Por, njëkohësisht është edhe kënaqësi e madhe kur sheh produktin të përfunduar.

A.D.: Si njohëse shumë e mirë e italishtes, ju, edhe keni përkthyer krijime letrare nga autorë të njohur për t'i

vendosur në portal. Si është të përkthehet për këtë qëllim, pa prituri një botim fizik të përkthimit?

V.V.: Disa kanë qenë arsyet që më kanë bërë t'i kthehem dashurisë së vjetër, përkthimeve, formatin audio të cilëve e kam vënë në faqen e audiolibrit shqip. Fillimisht lidhej me dëshirën për ta ndarë me dashamirësit e audiolibrit, atë kënaqësi që kam provuar unë kur i kam lexuar, apo dëgjuar, por edhe për arsye copyright-i. Përkthimi është kënaqësi më vete. Një numër i madh materialesh pret radhën në kompjuterin tim.

A.D.: Ndërkohë, para disa vitesh, jeni nderuar me Çmimin e Filantropisë. Si e kujtoni atë moment?

V.V.: Menjëherë pas *Panairit të Librit*, Tiranë 2016, ku për herë të parë krahas librit radhitet edhe audiolibri, *Volumi Audiolibra* do të nderohej me çmimin prestigjioz: *Çmimi i Filantropisë*, 2016. Unë, akoma sot, e kujtoj me aq emocion, sa që më duket si një ëndërr e bukur. Ishin fillimet, e meqë nuk kisha mundësi krahasimi (nuk kishte asnjë website tjetër për audiolibrin në shqip, më vonë do të krijohej në "Vodafone books" dhe akoma më vonë, do të dilte edhe "Sigal"), pra kisha nevojë që të më thonin se përpjekjet tashmë dyvjeçare nuk kishin qenë të kota. Mirënjohje pa fund!

A.D.: Sikurse e përmendëm dhe më lart, duke qenë se jemi në fillim të vitit 2021, natyrshëm më lind pyetja: keni ndonjë plan konkret për këtë vit? Ndonjë vepër, leximi i së cilës pret të përfundojë sivet?

V.V.: Sikurse ju thashë, një numër i madh pret në radhë. Nëse me autorët shkodranë kemi bërë një punë jo të vogël, këtë vit shpresoj të realizojmë gjëra të mira edhe me veprat e Naim Frashërit, Çajupit, Lasgush Poradecit, Mitrush Kutelit, Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit etj.. Por gjithnjë mbetet problemi i të drejtës së autorit. Do bëjmë më të mirën së bashku me lexuesit vullnetarë. Po ashtu kam në dorë përkthime nga **Marguerite Duras, Friedrich Dürrenmatt etj..**

A.D.: Dhe diçka të fundit: Ka njerëz që e duan librin, kryesisht të rinj, të cilët mund të kenë dëshirë të japin kontributin e tyre në audiolibrin shqip... Ju, besoj, i mirëprisni! Ata, si duhet të veprojnë?

V.V.: I mirëpres me shumë gëzim. Mënyrat e komunikimit janë të ndryshme, por po përmend dy më të përshtatshmet:

a) Pasi të regjistrohen në faqen e audiolibrit, mund të dërgojnë një e-mail ku shprehin dëshirën dhe do të mund të komunikojmë për zgjedhjen e materialit dhe cilësinë e leximit e regjistrimit.

b) Ose thjesht një material, një tregim të shkurtër apo poezi, ta dërgojnë në adresën vvolumi@yahoo.it.

Ju jam shumë mirënjohëse për këtë mundësi për të shtuar lexuesit vullnetarë.


Së fundi, duke ju uruar suksese të mëtjeshme në punën dhe krijimtarinë tuaj, ju falënderoj nga zemra për këtë mundësi për njohjen edhe më gjerë të audiolibrit shqip.



STUDIM MBI PAKICËN SHQIPTARE TË RUMANISË

Instituti per Studimin e Pakicave Kombëtare, me seli në qytetin e Kluzhit, publikoi para pak kohësh një studim prej 200 faqesh kushtuar minoritetit shqiptar të Rumanisë. Libri përmban artikuj të disa autorëve rumunë që janë marrë me problemet e këtij minoriteti, si Xhelku Maksutovici, Cătălina Vătăşescu, Marius Dobrescu, Cristia Maksutovici, Radu Săvulescu, Plainer Zsuzsa. Një numër të konsiderueshëm faqesh i është dedikuar historisë së këtij komuniteti nga historiani i njohur Gelku Maksutovici, autori i historisë së parë të shqiptarëve të Rumanisë. Duke filluar nga vala e pare shqiptare të arritur në tokën rumune në vitin 1595 dhe deri në ditët tona, studimi i Maksutovicit na jep të dhëna historike interesante mbi jetën dhe karrierën e familjeve shqiptare që përbëjnë komunitetin e sotëm. Një artikull tejet interesant është ai i Marius Dobrescu, i cili analizon komunitetin shqiptar nga pikpamja sociologjike. Dobrescu bën një prezantim të komunitetit duke filluar nga origjina e anëtarëve të saj, duke kaluar pastaj te zhvillimi socio-ekonomik të tyre dhe duke arritur në vitet e komunizmit. Ashtu si në atdheun e tyre, shqiptarët e Rumanisë kanë qenë të detyruar t'i nënshtrohen këtij regjimi shtypës, i cili e niveloi, e barazoi dhe e varfëroi shoqërinë rumune. Artikulli i Cătălina Vătăşescu është një prezantim i përgjithshëm i pakicës shqiptare të Rumanisë, kurse ai i Radu Săvulescu bën një histori të organizatës që përfaqëson sot këtë pakicë, Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë. Libri i Institutit per Studimin e Pakicave Kombëtare ka një rëndësi të veçantë në literaturën mbi minoritetet kombëtare të këtij vendi. Ai është, në fakt, një prezantim shkencor poliedrik dhe i shumanshëm i atyre që gjatë dy shekujve të fundit kanë kontribuar për zhvillimin e vendit të prindërve të tyre dhe, në të njëjtën kohë, të vendit që është bërë atdheu i dytë e tyre, të Rumanisë.

MIRA SKËNDERI
Bukuresht



"Letërsia shqipe si metafizikë dhe transhendencë" i Ermira Alija

GJURMËT

Nga Britni Gera

"Ku qëndron letrarësia?" është pyetja që shtrohet në fletët e monografisë e kjo letrarësi asnjëherë nuk përkufizohet ngurtësisht. Letrarësia duket si shënim i herëpashershëm i peshores që lëkundet midis shumë peshash.

"Pse janë shkrimtarë?" ... Letrarja qëndron në formën se si strukturohet, ... në individualitet, ... në shfaqje të shpirtit njerëzor përmes një uni poetik ndryshe. ... Letrarja është shfaqje individualiteti, ... spontanitet, trashëndencë. A i gjejmë këto elemente në letërsinë tonë? Apo qëllimorja e saj është pjesë e artit?

Pyetje të tilla nuk pranojnë përgjigje të thjeshta si "po" ose "jo" dhe natyrisht duhet një bazë teorike për të kultivuar mendim dhe shtysë interpretimi mes dritës e hijes që duket se ndërrojnë kahe nganjëherë.

Flasim për letërsi qëllimore, por me çfarë qëllimi u shkrua letërsia shqipe?

Në parathënien e kronikës së romanizuar të Barletit shkruhet se synimi i veprës është që të mbrohet nga harresa heroit i shqiptarëve. Përtej kësaj, na tregohet se si rrëfimi mëvetësohet dhe qëllon të takojë ngjalljen e kënaqësisë.


Në mënyrë progresive, kapërcime të tilla vërejmë edhe në letërsinë e shenjtë, ku fjala predikuese bëhet art e letërsia bëhet ndihmëse e librave të shenjtë në kërkimin hyjnor të së vërtetës, ndriçuese në rrugën e "zbulimeve të mëdha". Flitet për largim të letërsisë nga një formë e qëllimorja, por jo nga qëllimorja.

Në veprën e De Radës e Naim Frashërit, letrariteti përcaktohet si një komponente artistike që është vështirë të shkëputet nga qëllimorja, po aq sa është e vështirë edhe të identifikohet me të.

Në këtë linjë arsyetimi duket se shumëkuptimësia e transhendencia e letërsisë është ndihmëse e njeriut, por jo përcaktuese e tij. Ndoshta ka ardhur koha t'i kthejmë letërsisë këtë pjesë të idealizmit, - thotë autorja.

"Dëgjova një zë që thërriste në gjuhën shqipe" që dëshmia më provokuese për gjurmën e një prej gjuhëve më të vjetra të gadishullit.

Edhe monografia ecën duke hetuar gjurmë shpesh të padukshme e që mes rreshtash na lë hapësirë të bollshme për të reflektuar mendime e në një farë mënyre, na e provokon për ta bërë këtë.



A e keni menduar ndonjëherë se sa e rastësishme është dëshmia e parë e deritanishme për gjuhën tonë: "Dëgjova një zë që thërriste në gjuhën shqipe" ...

Nuk e di pse më lindi një dëshirë që fjalët e dëshmisë së parë të ekzistencës së shqipes t'i shihja si asociacione më të thella elementesh që lidhen me të lënit gjurmë: ..."dëgjova" - dëshmi ; "zë" - individualizëm ; "thërret" - shprehje ; "gjuhë" - potencë ; "shqipe" - spiritualizëm, mister...

Ndoshta sepse raporti i vendit tonë me gjurmët ishte një prej formave të mia reflektuese të momentit mbi librin *Letërsia shqipe si metafizikë dhe transhendencë*, të autorës Ermira Alija, duke e konceptuar edhe letërsinë, me një këndshikim prej dëshmie.

Për letërsinë është shkruar e diskutuar pafund e ndoshta kjo pafundësi interpretimesh është ajo çka i jep magjepsjen e pashtershme që i krijon lexuesit letërsia në vetvete, por edhe studimi mbi të. Subjektiviteti gjithnjë sjell risi. Fundja, thuhet se ne ndoshta i njohim të gjitha ngjyrat e hënës, por fakti që na serviret përherë ndryshe, na mban adhures përjetë të saj.

Teknika të tilla të përdorura në libër, që tërheqin vëmendjen e lexuesit, i japin nuanca letrarësie vetë studimit mbi letërsinë. Ato i tejkalojnë shtigjet e hulumtimeve duke i hapur rrugë pavetëdijes e emotivitetit si mister që i jep librit më tepër magjepsje sesa ndjesi të një analize të ftohtë shkencore.

KONCEPTI HEGELIAN I “VDEKJES SË ARTIT” DHE PIKTURA E LEKË TASIT

Një syzim estetik

Nga Stefan Çapaliku

Idea e vdekjes së artit, e artikuluar për herë të parë nga Hegel (1770-1831), është interpretuar dhe keqkuptuar në mënyra nga më të ndryshmet. Hegel, në realitet, nuk është shprehur kurrë për fundin e artit si të tillë, por për hyrjen e tij në një fazë të re të zhvillimit. Kjo fazë e re zhvillimi dallohet prej humbjes së dalëngadalshme të referencave përngjasuese.

“Përfaqësimi i një realiteti nga një vepër arti” bëhet përherë e më i vështirë dhe përherë e më i tërthortë. I ashtuquajtur “pasqyrim i realitetit” vjen dhe mbushet me kaq shumë elemente konceptuale, sa humbet çdo menjëhershëri. Immediatia vihet në dyshim.

E gjitha kjo trondit në themel idenë tradicionale të bukurisë. Kategoria estetike e së bukurës me këtë rast vihet në dyshim, apo më së paku ndërlikohet dhe nis të tërhiqet mënjane, duke mos iu imponuar më veprës së artit, si një kusht i domosdoshëm. Procesi tradicional i “pasqyrimit” të realitetit vjen dhe pasurohet prej dhjetëra elementesh intelektualë. Kështu ky arti “i ri, i intelektualizuar” shndërrohet në një fakt përherë e më privat, i lidhur pazgjdhshëmrisht me subjektivitetin e artistit.

Pra e thënë me pak fjalë, fundi i artit duhet të kuptohet vetëm si fundi i metodës së pasqyrimit artistik tradicional dhe si lindje e një “pasqyrimi të ri”, gjatë të cilit proces, përparësinë e merr koncepti, mendimi dhe jo hedonistikja.

Idea e vdekjes së artit është idea e fundit të çdo lloji autonomie të krijimit artistik. Po kështu ajo shënon edhe fundin e pretendimit të përparësisë së artit, mbi filozofinë, siç pretendonin romantikët.

Në këtë kontekst historikisht të largët dhe kulturalisht më të afërt se kurrë për ne shqiptarët, mendoj se duhet vështruar vepra artistike e Lekë Tasi (1929). Lekë Tasi, i cili nuk ka kaluar asnjë ditë në shkollat artistike, as të Shqipërisë e as të ndonjë vendi tjetër, është në mendjen time, shembulli i vetëm dhe absolut në historinë e artit shqiptar, i atij që ka kuptuar dhe zbatuar në mënyrë konseguente, çfarë nisëm të themi më lart.

Lekë Tasi, piktura e të cilit nuk ka jetuar as edhe një ditë të vetme në epokën e Realizmit Socialist, nuk është vetëm artisti pamor, që ka vertetur në praktikën e përditshmërisë së vet problematikën e reja estetike, por në përgjithësi artisti shqiptar me A të madhe, që na ka dëshmuar angazhimin e vet martir, në realizimin e këtij koncepti të ri posthegelian.


Lekë Tasi vazhdon të jetojë në mënyrë permanente një status të lartë të të menduarit për të renë. Dhe kjo shihet qartë në gjestet e tij minore të artit bashkëkohor, art i cili s’është asgjë tjetër përposë se një përgjigje ndaj sfidës së Hegelit.

Nëse Hegeli ka deklaruar diçka si puna e asaj që “arti ka vdekur”, atëherë duhet të kuptojmë se ai e ka pasur fjalën te fakti se arti nuk është më i aftë të përmbushë detyrën themelore, të cilën kishte marrë përsipër: të na tregojë të vërtetën. Sepse ndërkohë vetë e verteta na kishte dëshmuar se është diçka përtej pamjes natyrore dhe shqisore, përtej pamjes sensuale, se është e çliruar nga kufijtë natyrorë të rregullit. Kështu të vërtetat më të larta të vetëdijes dhe intelektit nuk mund të kapen në mënyrë sensuale. Sipas Hegel, koncepti i Zotit nuk ishte më i aftë të kuptohej me ndjeshmëri. Zoti nuk kishte më një imazh ose tingull të mundshëm, dhe së fundmi realiteti i plotë i lirisë nuk mund të kapet nga asnjë vepër arti.

Parë nga kjo prespektivë, te piktura e Lekë Tasi kemi përpjekjet titanike që qenia njerëzore bën për eksteriorizimin e vet. Kemi të kuptuarit që na sjell njohja e asaj që jemi përtej çdo paraqitje sensuale, sepse vetë realiteti që ai na përçjell është më shumë se pamja sensuale e botës. Spektatori i pikturës së Lekë Tasi duhet të jetë i përgatitur se piktura së cilës po i qaset nuk mund t’i sigurojë pasqyrën e realitetit të vet dhe asesi t’ia përmbushë nevojat për vetëkuptim. Ato janë thjesht disa instrumente që na ndihmojnë ta kuptojmë më qartë natyrën e botës.

Vepra të tilla piktorike si: “Ribalte”, “Teatri”, “Mbrëmje automanivelle”, “Sing(er) all”, “Koncert”, “Grua në kopësht”,

“Mbrëmje fatale”, “Autobuz III”, “Permetina”, “Beratina” etj, shënohen më së tepërmi nga autoriteti intelektual i artit, me të gjitha përparësitë që i burojnë nga zotërimi i fushave të dijes, shkencës dhe filozofisë. Vetë arti i Lekë Tasi i ka hapur shteg këtij personaliteti autorial. Kështu ai na fton për konsiderata intelektuale, dhe kjo me qëllim krijimin e një arti dhe spektatori të ri.



Tri letra të panjohura të poetit Manush Peshkëpia (ose një ese për poezinë)

Nga Uran Butka

Pikërisht ditën e 26 shkurtit 2021, të premten, pra, ditën e përvjetorit të 70-të të pushkatimit të poetit Manush Peshkëpia më 26 shkurt 1951, zbulova në Arkivin e Shtetit tri letra të panjohura të tij, që mbajnë datat 30 qershor 1944, 31 korrik 1944 dhe 17 gusht 1944, fondi 54, dosja 67 dhe që i drejtohen Sotir Kolesë, atdhetarit dhe dijetarit të shquar.

Ishte rastësi, apo një zë i paplotësuar, i paqetë, që nuk rreshti së trokituri tek unë pikërisht atë ditë?

Zërat e pavdirë, që vijnë nga e kaluara dhe që përbëjnë nënkresën tonë, duhet të jemi të aftë t'i kapim, t'i dëgjojmë dhe t'i ndjejmë, për të kuptuar rrënjët tona.

Zëri i Manush Peshkopisë na vjen sot përmes tri letrave tejet interesante, në të cilat autori shfaqet në fushë të kulturës shqiptare e më gjerë si një hulumtues, njohës dhe kritik i poetikës shqiptare në përgjithësi dhe poetikës së Çajupit në veçanti.

Manushi ishte edhe vetë një poet i ndjerë, përkthyes dhe studiues.

I rritur në një mjedis familjar e shoqëror nacionalist dhe të kulturuar, në mes të librave dhe njerëzve të ditur, Manush Peshkëpia u afirmua si një personalitet fuqishëm atdhetar, por edhe si krijues. Rugës së krijimtarisë letrare ai i ishte futur aty nga fundi i viteve '20-të dhe u shqua në vitet '30-40 për krijimet poetike, por edhe për përkthimet nga frëngjishtja, italishtja dhe anglishtja. Gjithashtu, u bë i njohur sidomos në rubrikën e ndërtuar bashkë me Mid'hat Frashërin "Të huajt për ne, ne për të huajt".

Bashkëpunimi me Mid'hat Frashërin ka qenë i frutshëm në fushën e kulturës, por edhe të idealit të përbashkët kombëtar. Po kështu edhe komunikimi me vëllain e vet nacionalist Nexhat Peshkëpinë, Vedat Kokonën, Mitrush Kutelin etj

Në esenë "Poemi i Shëndaumit" të Mitrush Kutelit, transmetuar më 19.04.1944 nga M.Peshkëpia në Radio Tirana, ku drejtonte emisionin letrar, ai tërhoqi vëmendjen e opinionit publik për një "shqiptar të

ri me vlerë dhe intelektual në kuptimin më të gjerë të fjalës", për talentin e letrave shqipe, Mitrush Kutelin.

Poezitë e M.Peshkopisë shfaqeshin tek revistat me prestigjioze të kohës, sidomos tek "Përpyjekja shqiptare" e Branko merxhanit, krahas krijuesve të poetëve të viteve tridhjetë, si Nexhat Hakiu, Vedat Kokona, Nonda Bulka, Dhimitër Shuteriqi, Sotir Caci, Arshi Pipa etj.

Me këtë rast po japim për lexuesin poezinë lirike të njëzetvjeçarit Manush Peshkëpia titulluar "Shpirt'i ri", botuar në revistën "Përpyjekja shqiptare":

Nëndë muaj n'errësirë
Nëndë muaj krejt i mpirë
E zë mall' i përvëlur.
shpirt' i ri posa gatuan
N'errësirë s'duron dot,
Do të vijë në këtë botë
Të shoh' dritën e kulluar.
Shpirt' i ri posa gatuan
Lindi, ra në botën t'onë,
Po – i shkreti shpirt' i njomë
Zu të qaj', oh, i penduar!

Është shpirti i ri, i sapogatuar, i Manushit dhe i brezit të ri përparimtar të asaj kohe, që ëndërronin për një botë të re, që digjeshin për një dritë të kulluar, por që ranë një botë të vrazhdë e të trishtë, zhgënjyese. "Revista letrare" shkruante atëbotë: "Doli nga shtypi libri i M.P., por nuk gjindet asnjë kopje e këtij botimi". I zhgënjyer autori që

s'pa as dritën e botimit!

Manushi spikati më së shumti si poet i vetvetishëm dhe i ndjerë. Atë e ka çmuar veçanërisht albanologu gjerman Maksimilian Lambertz, njohës i mirë i gjuhës, letërsisë historisë shqiptare, i cili në botimin "Antologjia e letërsisë shqiptare" (Albanishes Lesebuch, Leipsig, 1948) e përshtiu edhe poetin Manush Peshkëpia, duke botuar edhe dy vjersha të tij "Nënës" dhe "Flokëvedhës".

Shkrimtari dhe përkthyesi i mirënjohur Vedat Kokona është shprehur kështu për mikun, poetin dhe njeriun Manush Peshkëpia:

"...Shumë nga shokët e mi vdiqën zemërplatur pas dekada vuajtjesh dhe mjerimesh. Një nga këta fatzinj, ishte dhe ti, Manush. Askush nuk të ka njohur sa të kam njohur unë, si vëllai yt, gjashtëdhjetë vjet më parë, atëherë kur ti dhe unë gicilonim muzën dhe këndonim pranë burimit të Hipokrenit. Si duket,

Polimnia s'na deshi shumë dhe na la... Shumë njerëz kam njohur në jetën time, pak kam çmuar, shumë pak kam dashur



siç të kam dashur ty. Ti shkruaje vjersha pa e hequr veten poet. Të mos jesh poet, s'është faj. Faj është të mos jesh njeri. Ti, Manush, ishe poet-njeri. Pak poetë kam njohur të tillë. Mund të bësh vjersha patriotike sa të duash pa qenë as poet e as patriot, siç ka shumë, por vështirë tepër ta duash atdheun dhe gjuhën si i doje ti. Ti doje një Shqipëri demokratike, të cilën, për fatin tënd të zi, nuk

pe, sepse re tok me shokët në një varr të përbashkët. Ti doje një Shqipëri demokratike, të cilën ne të tjerët patëm fatin ta shohim. Për të vazhduar udhën që kishe ndërmarrë ti, neve na duhet ajo dashuri që kishe ti për vendin e shumëvujtur dhe për gjuhën e ëmbël shqipe. Lum ata nga pasardhësit e tu që do të vazhdojnë udhën tënde të ndriçuar nga drita jote."

*

Tri letrat e pabotuara më parë, që po sjellim për lexuesin, i drejtohen dijetarit Sotir Kolea, njëherësh edhe mikut të familjes Peshkëpia. Në atë kohë Manushi punonte si redaktor në "Radio Tirana" dhe ishte atje një zë i spikatur i kulturës shqiptare. Në kohën që do të jepte një emision radiofonik për poetin Andon Zako Çajupi, i kërkonte me përgjërime të urtit Sotir Kolea informacion për jetën dhe veprën e Çajupit, sepse po përgatiste edhe një botim (broshurë) për krijimtarinë thuajse të panjohur të Çajupit. Sotir Kolea kishte jetuar disa vjet në Egjipt, ku banonte Çajupi dhe e njihte mirë jeën dhe veprën e tij.

Shfaqet qartësisht prirja e Manushit për hulumtime dhe studime të reja në fushë të letërsisë dhe autorëve të saj.

Ndryshe nga dy letrat e tjera, ku kërkon informacion, në letrën e dytë të datës 31 korrik, Manush Peshkëpia shfaqet si një mendimtar evropian, drejtpeshues paanshëm i letërsisë, gjykues pa komplekse dhe tejet original për poezinë e Çajupit, por edhe të autorëve të tjerë të letërsisë shqiptare edhe të huaj. Madje kapërcen edhe mendimin që i shfaq Sotir Kolea në letrën-përgjigje të tij lidhur me Çajupin, i cili e kishte stigmatizuar dhe konfliktualizuar publikisht Dr. Adhamidin, këtë personalitet historik si edhe familjen e tij, siç bëri edhe me Mid'hat Frashërin tek "Klubi I Selanikut". Ndryshe nga ç'e paraqiste Çajupi tek komedia "Pas vdekjes" si një mjek të paafte dhe sharlatan, Dr Adhamidi, doktor në mjekësi i Universtitetit të Montpellierit, ishte njëherësh edhe kryetar i shoqërisë "Bashkimi" të Egjiptit, ministër në qeverisjen e Princ Widadit, përfaqësues i parë i shtetit shqiptar në Romë, kryetar i Komitetit shqiptar në Gjenevë, që dha një ndihmesë të madhe në mbrojtjen e çështjes shqiptare nëpërmjet shkrimeve dhe përpyekjeve të tij përgjatë Konferencës së Paqes në Paris dhe Lidhjes së Kombeve, si edhe me letrën drejtuar Presidentit Wilson në vitin 1918.



Ja reagimi i Manush Peshkopisë, kur merr përgjigjen e S.Kolesë:

“Nuk përjashtoj se jeta e poetit tonë Çajup s’ka qenë skandaloze, por ngul këmbë se vepra e tij nuk është për t’u hedhur poshtë, apo për t’u fshirë... Episodi i poetit Çajup me familjen Adhamidi nuk ka qenë i huaj per mua, dikush më kish bërë fjalë për të. Por ky episod, që unë bashke me ju e quaj të turpshëm, nuk ia unj vleftën poezisë së Andon Çakos. Marr lejën që me këtë rast t’ju kujtoj se kam lexuar në vëllimin “Poesia” të Benedetto Groces, kur ky thotë se për të gjykuar një vepër të një poeti, nuk duhet ta nënvleftësojmë këtë me jetën private të autorit... Për të vleftësuar vleftën e një poeti nuk duhet ta konfondojmë këtë me jetën private të autorit, këto janë dy gjëra që nuk lidhen me njëra tjetrën, thekson Manushi.

Siç shihet, poeti dhe studiuesi objektiv Peshkëpia, qysh në atë kohë, përshfaq forminin e tij si një mendimtar dhe kritik modern perëndimor në gjykimin e shkrimtarisë. Këtu ai del në fushën e teorisë së letërsisë dhe i paraprin mendimit më përparimtar shqiptar, ndryshe nga mendimi zyrtar i kohës së tij, por edhe i kohës më pas, diktaturës, kur vlera e një poeti përcaktohej nga deologjia apo elementet e biografisë së tij së tij, siç ndodh shpeh edhe sot e kësaj dite.

Manushi gjykon me kokë të tij dhe me këmbë në tokë: “Unë për veten time jam i mendimit, që kur gjykojmë shkrimtarët, e sidomos poetët tanë, duhet të rrojmë brenda atmosferës sonë. S’kemi pse të matemi me shtetet e tjerë, as ballkanas, pa le pastaj evropianë. Dhe duhet të kemi paraasysh se gjuha jonë e shkruar letrare s’e ka arritur as shekullin dhe, pra, s’kemi një traditë letrare. Mund të mburremi vetem me folklorin tonë të pasur, Kështu, pra, që Çajupim mund ta cilësojmë si poet të tonit tonë popullor, ashtu se edhe të tjerë. Por, siç thosha edhe me lart, Çajupi, të paktën ka marrë nga goja e popullit dhe është munduar ta veshë me petkun e poezisë, brenda mundësive te tij dhe në gjuhën tonë të pazhvilluar Dhe të mos harrohet sidomos që ay ka bërë poezi gjysmë shekulli më parë, ahere kur s’kishte nje alfabet të caktuar, po sikushdo shkrimtar e trillonte një abece të tijën”


Manushi mendon se çdo poet ka shtatin e vet, ndricon botën me dritën e vet të vetmjaftueshme, aq sa ka fuqi dhe shpirt. Këtë mendim ka edhe per vetveten. Bukur e përcakton Vedat Kokona: “Ti shkruaje vjersha pa e hequr veten poet. Të mos jesh poet, s’është faj. Faj është të mos jesh njeri. Ti, Manush, ishe poet-njeri”.

Koha e ardhme do të sjellë të tjerë poetë e të tjera vlera më të mëdha, mendon Manushi. “Gjersa të kemi edhe ne një Dante, një Gëte, një Shekspir, ka për të

kaluar kohë e gjatë, ndofta mund të nevojiten shekuj me radhë. Nashti për nashti kemi vetëm këta. Midis Fishtës e Shirokës, Naimit dhe Çajupit, Asdrenit dhe Lasgushi, Nexhat Hakiut dhe Vedat Kokonës, ndryshimi është shumë relativ. Një notë më e mirë, një numër më pak. Vleftë absolute nuk kemi. Sikur të marrim n’analizë veprën madhështore edhe të madhështorit Fishta, pikërisht në kryeveprën e tij “Lahuta e Malcis” besoj se edhe atje do të gjejmë vargje dhe jo poezi, dhe ndofta jo tek tuk”.



Manushi ishte gjithnjë në kërkim të vetes dhe të të tjerëve. Ai nuk nginte mite, por edhe as nuk minimizonte kërkënd. Ishte kundër atyre, që disa poetë i ngrinin në qiell, ndërsa të tjerët i i ulnin në tone minore. Ai përpiqet t’i afrohet të vërtetës, ndonëse jo gjithnjë ia arrin. Se edhe ai vetë poet është. Ai shkruan: “Çajupin, një shoku im “dottore in lettere” ma cilësoi si poet të tonit “minor”. Unë e kundërshtova dhe i thashë: Po cilët kemi ne në Shqipëri të tonit “madhor”? Ndoshta Fishtën, sepse reklama e madhe e ka ngritur në qiell, atje tek nuk qëndron dot. Bile dikush e ka vënë në krah të Homerit, ashtu sikundër, këtu e tre vjet më përë, një i krisur mendsh e vuri Ethem Haxhiademin tonë kundruall Sofokliut. Por këto, i nderuar z.Kolea, janë krahasime qesharake dhe dëftejnë se nuk jemi të gatuar ende. Emrat e Homerit, Sofokliut e të tjerë janë yje që shkëlqejnë prej mijëra vjetësh, dritën e të cilëve s’kanë mundur ta errësojnë as Dantet, Hygotë dhe Shekspirët”

Është me interes të theksohet se anash letrës dërguar S.Kolesë, M.Peshkëpia shënon me shkrim dore: “Si vete puna e fjalorit të gjuhës sonë? Akini edhe shumë për të punuar? Ai ishte i interesuar për punimet shkencore të Sotir Kolesë dhe e punëtorëve të tjerë të shqipes. Dihet se puna më e madhe, më e plotë studimore e Kolesë mbetet hartimi i pesë fjalorëve shqip grengjisht, shqip greqisht etj, ku më kryesori ishte fjalori i gjuhës shqipe, ende i



pabotuar, për të cilin punoi që nga viti 1905 e deri në fund te jetës, duke përdorur metodën e krahasimit për çdo fjalë të shqipes me fjalorët më të mëdhenj të botuar në gjuhët greke e frenge.

Manush Peshkëpia zbuloi se n Bibliotekën Kombëtare (drejtor i së cilës ishte Sotir Kolea në vitin 1928) ekzistonte një pako e dërguar nga Jani Vreto, me nënshkrimin: “Të hapet në vitin 1945”, pra, pas 15 vjetësh nga koha e dërgimit.. Duke qenë se Çajupi kishte vdekur në vitin 1930, dhe po plotesoheshin 15 vjet nga ajo ditë, Manushi mendonte se plikoja me dorëshkrime do të ishte e A. Z. Çajupit, dërguar në atdheun e tij. Por edhe kjo hamendësi, enigmë apo fakt, u fshi nga koha, sepse viti 1945 ishte viti i fillimit të inkuizicionit në Shqipëri dhe jo i letrave, i poezisë.



4 mars
1916-2021

105 VJETORI I LINDJES SË PIKTORIT NEXHMEDIN ZAJMI

Piktori Nexhmedin Zajmi ka lindur me 4 mars të vitit 1916 në Trebisht të Peshkopisë. Në vitin 1931, filloi shkollën Teknike në Tiranë, në degën e bujqësisë (1931-34). Mësuesit e artit në atë shkollë Zef Dajci dhe Kol Shala, zbuluan te Nexhmedin Zajmi prirje për pikturë. E mbështetën të ndrrorë degën e studimeve, duke e regjistruar në dekoracion dhe e nxitën të vazhdojë rrugën e artit. Nga viti 1935-39, ai ndoqi Shkollën e Vizatimit ku gjeti përkrahje të veçantë nga piktori i njohur dhe mësuesi i asaj shkolle, Andrea Kushi, mësuesit Abdurrahim Buza, Odhise Paskali, Hamdi Rapi, Izet Bebeziqi, Nexhat Peshkopia, Mustafa Vilaj, Muhamet Hoxha. Më 19 maj 1939, mbaron këtë shkollë dhe po atë vit Zajmi filloi studimet në Akademinë e Arteve të Bukura në Romë, Itali. Më 1943, diplomohet, duke e mbrojtur diplomën me një figurë Nudo, Punëtori i vogël. Pasi kthehet në Shqipëri, më 1945, nis punën si mësues i vizatimit në gjimnazin e Tiranës. Një vit më vonë u emrua mësues i pikturës në Shkollën e Mesme Artistike "Jordan Misja", ku qëndroi deri në vitin 1963. Midis viteve që punoi në shkollën artistike, pati vetëm një ndërprerje një vjeçare (1955), kur u caktua drejtor i Galerisë së Arteve në Tiranë. Në vitin 1963 filloi punën e pedagogut në atelienë e pikturës në Institutin e Lartë të Arteve (Sot Universiteti i Arteve). Si pedagog ai punoi deri në vitin 1969, kur doli në "Krijimtari të lirë".

Veprimtaria e Zajmi në fushën e pikturës është e larmishme. Ai ka lëvruar në disa gjini, portrete, pajsazhe, kompozime etj. Me tablonë "Brendi në Theth", realizuar pas viteve të studimeve, Zajmi solli në pikturën shqiptare një trajtim artistik mjeshtëror dhe mendohej se e ardhmja e tij do të vijonte duke u thelluar në këtë hulli, duke përfaqësuar formën ekspresive të një realizimi të "ashpër". Por, që në vitet e para të pasçlirimit ai bashkë me piktorët më të njohur, të atyre viteve u detyruan të punojnë sipas metodës të realizmit socialist. Në ekspozitën e vitit 1945, ai realizoi portretin "Punëtorja mencës", tablonë e parë me temë nga klasa puntore. Më, pas me kompozimin "Tregim nga lufta" (1952) dhe me tablotë e tjera të mëvonshme Zajmi ndoqi thujtë të njëjtin qëndrim krijues, sipas skemave të artit zyrtar duke realizuar vepra që u vlersuan në atë kohë dhe më çmime kombëtare, si "Diga e Drinit" në vitin 1969. Midis veprave më të mira të Nexhmedin Zajmit vlersohen disa portrete. Ndonëse u realizuan në të njëjtën periudhë me tablotë tipike të realizmit socialist, ato çmohen për më shumë mjeshtëri artistike. "Dardharja", "Nëna labe", "Bajarm Curri", "Zadrimorja", "Delegati", janë ndër tablotë më të bukura të autorit. Në to ndjehet më qartë akademizmi i shkollës italiane, sidomos pasqyrimi botës së brendëshme të personazheve si dhe përpjekjet për t'u futur në psikologjinë e njeriut të kohës. Thujtë e gjithë krijimtaria e Zajmit zhvillohet midis akademizmit të shkollës së Romës dhe shablloneve të realizmit socialist. Veprat që anojnë më shumë nga vitet e studimeve akademike mbeten më të çmuarat për autorin dhe pikturën shqiptare. Veç realizimeve të bukura në tipizmin e personazheve, Zajmi shquhet edhe për pikturim të shkrifët. Tablotë e tij, krijojnë një harmoni të dukshme ngrash pa kontraste të ndjeshme, me kalime të buta dhe të qarta dritëhije. Gjatë viteve të punës, aktivitetit të tij artistik Nexhmedin Zajmi vlerësohej midis piktorëve më të njohur të të gjithë vendit. Ai ka marrë pjesë thujtë në të gjitha ekspozitat kombëtare dhe në disa veprimtari ndërkombëtare. Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Zajmi është laureuar me Cmimin e Republikës, dhe me disa vlerësime të rëndësishme kombëtare, si "Artist i Merituar" dhe "Piktor i Popullit". Veprat e tij më të mira, ruhen në Galerinë Kombëtare të Arteve Figurative në Tiranë dhe në Muze të tjera të artit.



Piktori N. Zajmi ne studio

"Dardharja"

"Djaloshi", pune realizuar
në Akademinë e Arteve -Rome



Diga e Drinit



Tre poetë për gjyshen, nënën kur largohet nga jeta

Elsa Balliu

VDEKJA E GJYSHES Fatos Arapi	ELEGJI PËR NËNËN Frederik Reshpja	KUR VDIQA UNË Skënder Rusi
Ja, edhe gjyshja në arkëz, Kukull e vogël në kartëz. Është... dhe prapë s'është e tëra, sikur nuk është si përhëra. Gjithë karfica, gjilpëra' kapur satenet në kokë, lidhur këpuckat përposh, shami e lule në gjoks. Mbyllur kapakët e syve (ç'diej u shuan brenda tyre?). E sheh...dhe të duket heshtja pe gjasme e pe gjasme vdekja. Gjyshja e vogël, e bukur, e pastër... Në arkëz kukull. Gjithë karfica, gjilpëra, qepur vite të tëra, lidhur kujtime e malle dhembje, që duken si përrallë. E sheh dhe të duket heshtja pe gjasme e pe gjasme vdekja.	Një avion ikën tutje përmes mjegullave, Si fatkeq i përzënë nga selia e dritave. Ah, ku ke rënë kështu, ku je tretur? Ka mbirë bari nga sytë e tu, Ka mbirë bari nga zëri yt. Nga kodrat po vjen nata duke u lutur për ty. Është ora kur hijet bien në gju, E ti rrin aty nën tokë, Te mermer i rrëzuar i perëndive... Tani që nuk je, dafina nuk lulëzon më, Vetëm zëri im i djalërisë jehon mbi gjethet e verdha, E dafina vendos kurora mbi lavdinë e muzgut. Ishte një botë e tërë kur ishte ti, Por erdhi kjo vetmi e madhe që fshin gjithçka; Tani vetëm në horizont Bëjnë kryq vetëtimat dhe nxjerrin thikat. Ah, ku ke rënë kështu, ku je tretur? Nënë, nënë, do të vijnë dëborërat, Do të bien mbi barin që ka mbirë nga zëri yt...	Më hodhët dhe`sa mundët, Më ngjeshët. Më vutë një mal përsipër! Më pas ca lotë, Më pas ca lule artificiale, Më pas, më latë e ikët! Më pas i latë duart, (nga dheu edhe nga unë!) Dhe shkuat, Drekuat(!) Dhe nisët Të qeshni përsëri, Të thoni barcoleta banale, T'i shkeln syrin njëri-tjetrit Me djallëzi! Ç'aktorë horrorë! Në tërë këtë lojë Me gjoja dashuri! Veç nëna, Eh, nëna! Hyri fshehtaz atje, brenda, Si një rreze dielli në dimër! Për të ndarë me mua, Gjithë atë mal dheu, Që më vutë përsipër! Veç nëna tani, Me zogjtë e gishtave, Më çuket si dikur, Më shpupuris flokët! M'i thërret Me emra, Shokët...

Poezitë më të arrira për gjyshen, nënën, motrën ilustrojnë funksionimin e shpirtit njerëzor ku poetët bindin lexuesin përmes përjetimeve individuale. Ndoshta momenti më pëlçitës është ndarja nga jeta. Poeti e kundron çastin e vdekjes për të nxjerrë në pah qëndrime subkoshiente. Për krijuesit mbetet silitës fakti që koha e vdekjes zgjat shumë më shumë se jeta dhe nga ana tjetër, para saj u krijohet mundësia të verifikojnë më mirë veten dhe të tjerët.

Të tre poetët trajtojnë largimin e njeriut nga jeta përmes vdekjes së natyrshme, larg notave mistike. Futen në lojë detaje të vëzhgimit poetik të ngacmuara me ndjenjë e mendim, të cilat bëhen të prekshme nga këndvështrimet origjinale: te Arapi, një vello e lehtë trishtimi mbështjell vdekshmërinë njerëzore; te Reshpja, largimi nga jeta i njeriut të dashur le pas dhimbje e vetmi të tejshkajshme; te Rusi struktura e sotme e të menduarit të njeriut, vendoset përballë dhimbjes së nënës si mundësi për të njohur thelbin e madhështisë së marrëdhënies nënë-fëmijë, mbetur e tillë në tejkohësi.

Detajet e ofruara në çastin kohor janë thellësisht bindëse. Në poezinë e Arapit e kemi para syve njeriun që ka dhënë shpirt, por kjo nuk e bën situatën domosdoshmërisht më të ngarkuar. Në poezinë e Reshpjes trupi rrin aty nën tokë, lexuesi ndjen ngado që hedh sytë mungesën dhe i mbetet në mendje nga jeta e poetit zëri im i djalërisë jehon mbi gjethet e verdha. Në poezinë e Rusit vihet përballë riti rutinë i varrosjes, me dashurinë e pamort të nënës.

Te poezia *Vdekja e gjyshes* e Fatos Arapit është fiksuar koha në çastin e emocionit të përmbajtur. Nuk ka aty britma, klithma, vaje tradicionale. Intensiteti i është nënshtruar ndjenjës së dyshimit naiv. Imazhi që përcjell Fatos Arapi në vargjet e para “Ja, edhe gjyshja në arkëz,/kukull e vogël në kartëz” kalamendet mes reales dhe ëndrrës, ndjesi që do të vazhdojë edhe më tej për ta bërë të pabesueshme praninë e vdekjes. Fjalët është dhe e sheh ndiqen nga reticenca që ka aftësinë të përmbledhë kohën e ikur: fishkjen, rrudhat, zvogëlimin. Autori nuk i kujton, nuk do të prishë imazhin e bukur të gjyshes që më së fundi i është dorëzuar kujdesit të të tjerëve.

Karficat, gjilpërat, lidhëzat kanë humbur kuptimin e parë dhe marrin vlerë ornamentale në panoramën e ngjirë

që e zbut pranëvënia me shami e lule në gjoks. Ato vogëlsira që mbërthejnë, kanë mundur të ndalojnë jo vetëm lëvizjet e gjyshes që qëndron në arkëz kukull, por dhe të shkuarën koncentruar në vargjet qepur vite të tëra, / lidhur kujtime e malle. Por të krijohet ideja se është një pengim i pranuar nga vetë gjyshja.

Segmenti kohor nga e tashmja, në të shkuarën, drejt së ardhmes skicohet me fjalën përrallë ngarkuar me misionin e mbartjes aty dhe gjatë kohës kur gjyshja të mos jetë. Asociacionet që krijon përdorimi i kësaj fjale lidhen pazgjithshmërisht edhe me fëmijërinë e fëmijët që kanë qenë e do të vijnë në këtë botë.

Imazhi i ndërtuar nga përdorimi i propashtesave zvogëluese; arkëz, kartëz, këpucka buron trishtim. Poeti nuk na jep asnjë penelatë të fizikut në të shkuarën, por theksimi i vogëlsisë në momentin e largimit të jep shtrëngim të paevitueshëm në gjoks që nxitet nga metafora e ngritur mbi emocionet e pyetjes retorike ç'diej u shuan brenda tyre? Vargu i zbërthyer (e sheh... dhe të duket heshtja / pe gjasme), copëzimi i tij (Gjyshja e vogël, e pastër, / e bukur) ndërton atmosferën e vetpërmbajtjes.

Autori është i ndjeshëm ndaj përsëritjeve. Përdorimi i kujdesshëm i tyre krijon muzikalitetin funebër të poezisë. Poeti veçon fjalën është dhe e përsërit, disa herë përmend togfjalëshin gjyshja e vogël, rimerr brenda vargut grupin pe gjesme e pe gjasme, përsërit vargjet e sheh... dhe të duket heshtja/ pe gjasme e pe gjasme vdekja. Përdorimi i pjesoreve kapur, lidhur, mbyllur përveç shkallëzimit zbritës në semantikën e tyre përcjellin edhe tingëllimën e veçantë të zanoreve au, iu, yu.

Fatos Arapi arrin që përmes lartësimit të gjuhës së përditshme, të kapë kuotat më të larta të transmetimit të gjendjes specifike shpirtërore. Objektet e zakonshme karfica, gjilpëra, satene marrin kuptim të plotë me përdorimin e formës pe gjasme që ngjan sa fëmijore aq dhe e vjetër, por padyshim që përcjell me forcë naivitetin e brishtë të çastit ku bëhet e mundshme çdo pamundësi..

Poezia e Frederik Reshpjes është e mbushur me dhimbje therëse, sa njerëzore aq universale. Që në vargjet e para: Një avion ikën tutje përmes mjegullave,/Si fatkeq i përzënë nga

selia e dritave të fut në atmosferën e braktisjes, humbjes në përmasa qiellore, largimeve pa kthim.

Botë pa nënën është tjetërsuar, ka humbur vlerat, bukurinë. Poeti na jep asgjënë të rrethuar nga asgjëja: mjegullat, dritat, nata, hijet, muzgu, mermeri i rrëzuar i perëndive. Zhdukjen e avionit e bën më makabër peizazhi i tokës ku ka mbirë bari nga sytë e tu, / ka mbirë bari nga zëri yt. Gjithçka i shërben të kujtimit të saj. Nga kodrat po vjen nata duke u lutur për ty.

Vetmia e poetit bëhet apokaliptike pasi jetë jetës i jep vetëm fryma e nënës që tashmë mungon. Tani që ti nuk je, dafina nuk gjelbëron më, për ta çuar më tej imagjinatën e mbushur me zi, e ndihmon metafora dafina vendos kurora mbi lavdinë e muzgut, sepse vetëm natës që po vjen duke u lutur për nënën i takon lavdia. Por figura të krijon dhe mendimin se e vetmja zotëruese e jetës në tokë që kërkon e merr lavde është errësira. Për këtë ndihmojnë imazhet vrastare në horizont / bëjnë kryq vetëtimat dhe nxjerrin thikat.

Pëshpërma e përmotshme vjen e lehtë, torturuese përmes aliteracionit të strofës së dytë dhe të fundit. Bashkëtinëlloret *t* dhe *r* të përsëritura nxitin jehonën në ndjesitë e lexuesit

Ah, ku ke rënë kështu, ku je tretur?/Nënë, nënë, do të vijnë dëborërat,/Do të bien mbi barin që ka mbirë nga zëri yt...

Nëse Fatos Arapi e përdor reticencën të mbajë ndezur kureshtjen e lexuesit për pamjet që do të pasojnë, *E sheh... dhe të duket heshtja / pe gjasme e pe gjasme vdekja*, Frederik Reshpja në ato tre pika derdh pikëllimin e tij të pafjalë *E ti rrin aty nën tokë, / Te mermer i rrëzuar i perëndive...* Ndërsa te Rusi reticenca jep vazhdimësinë e pandërprerë të bisedës e të dhimbjes M'i thërret /Me emra, Shokët...

Leksiku poetik mbizotërohet nga fjalët me ngjyrimë zymtësie të dukshme: mjegull, fatkeq, i përzënë, nata, hijet, i rrëzuar, nën tokë, nuk lulëzon, muzg, vetmi, thikat, tretur.

Të tre poetët nuk i shpëtojnë shprehjes së drejtpërdrejtë të ndjenjave përmes pyetjeve retorike e pasthirmave.

Te *Vdekja e gjyshes* poeti të detyron të mbash sytë në një pikë e të meditosh. Kjo përshtypje të krijohet nga ngulmimi që përcjell forma E sheh e veçuar me reticencë, por dhe numërimi i objekteve të vogla brenda një hapësire të kufizuar.

Ndërsa *Elegji për nënën* hapësira e dhimbjes shtrihet nga vendi ku ka rënë, nën tokë deri tutje përmes mjegullave, në horizont. Pikëllimi i poetit i përcjellë te lexuesi, ka përmasa kozmike me shtrirje hapsinore, ka peshë sfilitëse që bën të shuhet magjepsjet e natyrës, por dhe ka ngecur lumturinë në vitet e djalërisë.

Vuajtja bëhet edhe më e papërballueshme kur bie mbi barin që ka mbirë nga zëri bashkë me dëborërat. Shumësi i fjalës borë të fut në atmosferën e përsëritjes së pandërprerë të ftohtësisë.

Poezia *Kur vdiqa unë* e Skënder Rusit merr barrën e pasqyrimin të komunikimit me veten, me të ngjashmit tanë, me jetën, të tashmen e të ardhmen përmes kodeve të një gjuhe të përjetshme si shenja të sjelljes mes dy kahjeve: të rutinës që asgjë nuk e trand dhe klithmës së dhimbjes që depërton përtej jetëvdekjes. Poeti zgjeron hapësirën e vet të komunikimit përtej kufijve të njerëzores.

Motivi i udhëtimit në botën tjetër përdoret nga poeti si mjet për të vizatuar plagët morale të shoqërisë ku e paprekur mbetet vetëm dhimbja e nënës që *Eh, nëna!/ Hyri fshehtaz atje, brenda,/ Si një rreze dielli në dimër!*

Një dialog i çuditshëm me njerëzit (shumësi flet shumë) e ngurosur në mospërgjigjen e tyre, e bën poetin t'u këlthasë aktorë horrorë. Rusi projektton natyrën e marrëdhënieve njerëzore në thelbin dhe imanencën e qenies, në strukturat e saj mentale përmes bashkëveprimesh korelative gjuhësore qëllimore e shpirtërore. Leksemat e përzgjedhura zvogëlojnë ligjërimin informues duke zgjeruar qenësinë emocionale. Bota kundrohet nën optikën e fjalës së ngjyrosur stilistikisht. Imazhi letrar zhvillohet shkallë: shkallë nga riti që vret me rutinën dhe hipokrizinë deri në realizimin e aktit sublim të mbetjes së nënës gjithmonë në pozicionin: *Me zogjtë e gishtave, / Më çuket si dikur, /Më shpupuris flokët!*

Vlerat fonike, melodike, ritmike përcjellin të dyja tablot: pjesa e parë, foljet hodhët, ngjeshët, vutë përmes veprimin përcjellin imazhin poetik të largimit të njeriut nga jeta. Dhe e përforcojnë këtë elipsat përmes mënjaniit tëp lotë të foljeve në dy vargjet pasardhëse, për të kulmuar me anaforën e më-ve, t-ve, d- ve,dhe si imazhe optike; në pjesën e dytë akti i vdekjes shërben si model për të realizuar vlerën kualitative të lidhjes nënë – fëmijë.

Sipas poetit Seamus Heaney, “Poezia është rruga e ardhjes për së dyti te gjërat që ndodhin në kohën e duhur”. Dhe poetët tanë kanë mundur të na kthejnë në vendngjarje përmes rrugëve tërësisht personale, Qasja poetike ndaj frymës që mbizotëron në çastin mortor apo pas mortor, realizohet me mjetet vetiake të secilit autor, por të dy arrijnë të përcjellin te lexuesi mendësi specifike. Varësisht prej synimit të krijuesit, secila nga poezitë është burim imazhesh me origjinalitet të brendshëm, të pangatërrueshëm edhe pse motivi është i përbashkët.

Korpusi kadarean: VARIANTE TITULLORE NË AREALIN FRANKOFON

Dr. Jorina Kryeziu (Shkreta)

Krijimtaria e I. Kadarese njih një përtëritje të vazhdueshme brendatekstore, titullore e zhanrore drejt përplotësimit: kemi vepra të përplotësuar nga tregimi në roman (*Gjenerali...*, *Qyteti i jugut* në *Kronikë në gur* etj.), nga novela në roman (*Përbindëshi*, *Doruntina*, *Pallati*, *Muzgu* etj.). Po kështu, nga botimi në ribotim, vepra është retushuar – artistikisht – si kërkesë e vetë shkrimtarit, si përkryerje artistike, duke buruar vijimësisht prej rezervuarit autentik, për ta shndërruar në një dukuri e traditë të vetën, e cila përbashkohet dhe dallohet prej lexuesit që e njeh veprën si sistem, duke e shndërruar njohjen ndaj këtij korpusi në një “enciklopedi vetjake”. Këtij rezervuari, padyshim, nuk mund t’i shpëtojë as *aparati titullor*.

Titulli, si shenjë e element i rëndësishëm *paratekst*, përbën kontaktin e parë me veprën. Titujt kadareanë, burimorë e të përkthyer, janë metaforikë, metonimikë, shprehës të vlerave konotative e asociative e, njëherësh, joshës për lexuesin, duke e angazhuar atë në interpretim, ende pa nisur leximin. Raporti *titull – variant titullor* mund të kundrohet në disa aspekte, bazuar në stilin e shkrimtarit po dhe në përballjen (*face to face/ vis-à-vis*) me lexuesin.


Përkthimi i kësaj vepre në vitet ’70 të shek. XX, në Paris, bëri që Franca të shndërrohet në atdhe të dytë, ndërsa frëngjishtja, gjuha e madhe, shërbeu si përcjellëse për gjuhët e Evropës Perëndimore e më gjerë, duke u bërë urë lidhëse letrare-kulturore për përkthimet në: holandisht, finlandisht, suedisht, norvegjisht, portugalisht etj., madje edhe për arealet e afërta me shqipen, siç janë greqishtja e italishtja.

Gjatë hulumtimeve të kryera për titujt kadareanë në arealin frankofon, u evidentuan një sërë elementesh mbi veprimtarinë e përkthimit, specifikën gjuhësore dhe stilistike, krijimin e ekuivalencave semantike, riprodhime titullore identike të teksteve burimore, po dhe vepra me dy tituj brenda të njëjtë sistem pritës. Gjithashtu, u vërejt se variantet titullorë zunë fill në arealin frankofon, më 1972, me romanin *Kështjella*, i cili ndërrohet në *Daullet e shiut* (*Les tambours de la pluie*¹). Ky ndërrim, apo çështja e

ndryshimit ose/dhe ndërrimit të krejt titullit, shndërrohet në një marrëdhënie komplekse mes titullit dhe vetë veprës. Nga njëra anë, varianti titullor duket se nuk ndikon në përmbajtjen e veprës e, ndoshta, as në përzgjedhjen e saj për lexim, por, nga ana tjetër, nëse do të analizonim me përimësi faktorët brenda-e-jashtëtektorë, që kanë ndikuar në ndërrim, kjo mund të na çonte deri në një “semiotikë” historike-gjuhësore të titullit (Leo H. Hoek, *La marque du titre*), në të cilën nuk duhet të mënjanohet *përmasa socio-kulturore*. Në rastin e romanit *Kështjella*, kjo përmasë mund të na ndihmojë në kontekstualizimin historik të varianteve: *Kështjella/ Daullet e shiut/ Kasnecet e shiut/ Rrethimi* – të para si eksperimente letrare-gjuhësore-historike-kulturore, hallka e të cilit këputet te *Kështjella*, për të na larguar përfundimisht nga formula e gatshme e ekzotikës mesjetare. Këta tituj përshkojnë e bashkojnë të gjitha grupet diskurse, elementet peritike dhe njësitë joverbale të tekstit. Ky zinxhir titullor mbetet padyshim i qëllimshëm, u bindet dhe u përgjigjet procedeve artistike, si ligjshmëri të stisura nga vetë autori. Titujt, në këtë rast, hapin një horizont estetik dhe kanë efektet e veta të leximit e, madje, ngrënë disa probleme, “ndoshta më shumë se çdo element tjetër i paratekstit” (Gérard Genette).

Ndërtimi i “imazhit” të veprës, përmes perspektivës fillestare të elementit peritik, realizohet si një tërësi komponentësh ekzogjenë, që kërkojnë njohje të rregullave sintaksore, narrative, psikologjike apo edhe etike, duke marrë parasysh edhe shitjet – *fuqinë reklamuese të titullit*. Variantet titullorë të arealit frankofon nuk prekin vetëm sferën gjuhësore, po dhe atë kulturore, pasi, përgjithësisht, përfshijnë një aluzion kulturor, qoftë të lexuesit shqiptar/ të vendit të origjinës, qoftë të lexuesit të huaj/ të sistemit pritës.

Veprat kadareane, në shqip e në gjuhë të huaja, përmbajë një sërë elementesh peritike, me karakteristika të veçanta shtesë: nëntituj – kur kanë ose kur shtohen, “teksti”






i ballinës së pasme dhe/ose i jakës, fjalë/fraza shoqëruese, fotografi të shkrimtarit, parathënie/pasthënie/forma të tjetra, ilustrime të ballinave etj. Krahas titujve, edhe këto elemente shoqëruese luajnë një rol të posaçëm në bartjen e kuptimeve e mund të kenë impakt të menjëhershëm dhe funksion udhëzues, duke e ndjellë lexuesin në lexim, në interpretim po dhe drejt blerjes.

Në përkthime, lexuesi, në çastin që prezantohet me paratekstin, duket se nuk shfaq interes për marrëdhëniet gramatikore se dhe semantike midis dy gjuhëve: veprës dhe tekstit burimor/ të përkthyer/ ndërmjetës. Hapësira dhe shtrirja metalinguistike e titullit (Léo H. Hoek, 1973) mund të analizohen gjerësisht, aq sa në finalizimin e procesit të aparatit titullor, nuk mund të përjashtohet roli i “indutrisë” së botimit: botuesi, përkthyesi, kryeredaktori, redaktori – sidomos për të tërhequr shitje. Referuar audiencës së synuar, edhe titujt e kolanave apo të serive, të vendosura prej botuesve, kontribuojnë në identitetin dhe pritjen e veprës letrare, duke u shtuar të dhëna që shoqërojnë e “ndriçojnë” leximin, sidomos në sistemin pritës.

Ndërrim-kuptimi i këtyre titujve në veprimtarinë përkthimore nuk mund të mbetet një konfigurim kalimtar e as i rastit, model i propozuar apo variant, por

1 Titulli i parë i ndryshuar: *Les tambours de la pluie/ Daullet e shiut* (titulli burimor *Kështjella*), “Hachette Littérature”, Paris, 1972, përkth. Jusuf Vrioni.






shënjon kuptime linguistike e ekstralinguistike që lidhen drejtpërdrejt me veprën, me njohjen e “mekanizmave” gjuhësorë të variacioneve titullore dhe me rëndësinë e njohjes së tipareve specifike të stilit, përkthimi i të cilëve shfaqet si njësi tekstuale e posaçme në gjuhën e kulturën pritëse.

Ndër njëqindnjëzetepesë tituj burimorë ka fare pak tituj pa variante, si: *Përbindëshi*, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* (përveç përkthimit në portugalisht: *O general do exército fantasma/ Gjenerali i ushtrisë fantazmë*), *Autobiografia e popullit në vargje*, *Shkaba*, *Hija*, *Vajza e Agamemnonit*, *Pasardhësi*, *Aksidenti*.

Variante titullore dhe vepra me dy tituj

Dukuri interesante e këtij areali, përveçse ndërrimeve të titujve, mbetet edhe dinamika e ribotimeve, aq sa kemi vepra me variante titullore po dhe vepra me dy tituj, si vijon:


- * *Raste të veprave me një titull të ndërruar*
- *Kështjella* në *Les tambours de la pluie* (*Daullet e shiut*), titull që merret kalk i gatshëm edhe për përkthime në gjuhë të tjera: portugalisht, katalanisht holandisht, spanjisht, italisht, greqisht, kinezisht etj.;
- *Nga një dhjetor në tjetrin* në *Le Printemps albanais* (*Pranverë shqiptare*) – titull që do të merret kalk edhe për përkthimet në gjuhët e tjera;
- *Pashallëqet e mëdha* në *La niche de la honte* (*Kamarja*



e turpit) – ndryshimi ka ndodhur në frëngjisht dhe do të përdoret edhe në përkthime në gjuhë të tjera. *Pashallëqet e mëdha* konsiderohet një titull burimor (1978, 1989, në Tiranë; 1980, në Prishtinë), i cili nuk do të përdoret më as në botimet në gjuhën shqipe;

- *Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave* në *Le Palais de Rêves* (*Pallati i Ëndrrave*) – ndryshimi ka ndodhur në frëngjisht dhe do të përdoret edhe në përkthimet në gjuhë të tjera;
- *Nata me hënë* në *Clair de lune* (*Dritë hënë*) – ndryshimi ka ndodhur në frëngjisht dhe do të përdoret edhe në përkthimet në gjuhë të tjera;
- *Viti i mbrapshtë* në *L'Année noire* (*Viti i zi*) – ndryshimi ka ndodhur në frëngjisht dhe do të përdoret edhe në përkthimet në gjuhë të tjera;
- *Ndërtimi i Piramidës së Keopsit* në *La pyramide* (*Piramida*) – titull që do të përdoret edhe në përkthime në gjuhë të tjera etj.

- * *Raste të veprave me dy tituj*
- Kronikë në gur*: *Chronique de pierre* dhe *Chronique de la ville de pierre* (*Kronikë e qytetit të gurtë*);
- Dimri...: Le grand hiver* (*Dimri i madh*) dhe *L'hiver de la grande solitude* (*Dimri i vetmisë së madhe*);
- Koncert në fund të dimrit*: në *Le concert* (*Koncerti*) dhe *Le concert en fin de saison* (*Koncert në fund të stinës*);



Ikja e shtërgut: La menace du soleil (*Kërcënimi i diellit*) dhe *L'envol du migrateur* (*Ikja e shtërgut*) etj.

Bilinguizmi titullor

Në disa prej gjuhëve, kryesisht me alfabet jolatin, titujt kadareanë shfaqen në trajtë bilinge, duke u shndërruar në një praktikë përkthimore e sistemit pritës. Krahas titullit, kryesisht prej nga është përkthyer vepra, në gjuhën e sistemit pritës në ballinë bashkëvendoset edhe titulli në alfabet latin, kjo ka ndodhur në:

- Koreanisht–frëngjisht:
- Pasardhësi*: 누가후계자를죽였는가 – *Le successeur*;
- Vajza e Agamemnonit*: 아가멤논의 딸 – *La Fille d'Agamemnon*;
- Dosja H*: H서류 – *Le Dossier H*;
- Pallati i Ëndrrave*: 꿈의궁전 – *Le Palais des Rêves*;
- Kronikë në gur*: 돌의 연대기 – *Chronique de pierre*;
- Çështje të marrëzisë*: 광기의풍토 – *Un climat de folie* etj.
- Kinezisht–frëngjisht:
- Piramida*: 慾望金字塔 – *La pyramide* etj.
- Japonisht–frëngjisht:
- Prilli i thyer*: 砕かれた四 – *Avril Brisé*;
- Muzgu i perëndive të stepës*: 草原の神々の黄昏単行本 – *Le Crepuscule des Dieux de la Steppe* etj.
- (**Dukurinë e bilinguizmit titullor në gjuhët aziatike nuk e hasim vetëm për frëngjishten, por edhe për anglishten dhe për shqipen.*)



NURIE EMRULLAI

E fyti thahet nga këto mendime

E PËRZGJEDHURA

Jam e pafundmja në numër.
Infiniti që lindet për të shtuar veten.
Jemi specie në zhdukje vetëm nga mendja.
(një lloj animālis në shumim.
-Këtë mos e lexo me zë!
Këtë thuaje po je me nerva.)
Të përzgjedhurën e llojit e quajnë fatlume.
E fati te ne paracktohet në muajin e katërt.
Nga ty s’kërkohet shumë:
Rritu, martohu dhe lind.
Hap pas hapi ti bëhesh si tjetra.
Veshja jote është identiteti yt.
Identiteti njeri këtu ka humbur.
Jeta jote është e ditur si do të vejë:
Rritesh, martohesh dhe lind.
Shumimi i pafund i egos njerëzore.
Ruajtja e llojit brenda fisit është luftë.
Lufta më e egër tek ne është lufta e t (u)-r-u-pit.

Ikim sa më larg që mundemi, po instinkti thërret.
Të veprosh me instinkt është më pak lodhje.
Intuita u shtyp kur Eva u zhgënjye prej parajsës.

Jam e privileguara,
Infiniti i pjellorisë,
Po u ngatërrua edhe kësaj here çiftimi, s’ka gjë.
E rëndësishme është të ruajmë llojin tonë.
E rëndësishme t’i shkruhet fati muajin e katërt pa lind.

TEMENA

“Bie dhe zgjohem me mendje të kurdisur.
Ul ballin e sytë për ta nderuar nënën-tokë.
Ngri duart lart për t’iu falur qiellit.
ato më shohin në nderimet që bëj,
Çirren para meje, këndojnë, hedhin sheqerin mbi mua,
Që shumë lehtë mund të kthehet në gurë.”
Hopaaaa ha! Hopaaa ha!- gjëmojnë veshët e mi.

Hapat i hedh delikat
Dhe asgjë nga trupi im nuk duket.

Kënga që më këndohet mua
Krahasohem me hanën, zanën dhe dimrin e egër si zemra
e këtyre anëve.

“Përse bie kjo dauille?”

Ngjitja e vetme janë shkallët e dhomës.

Qaj ndër duvak dhe tri herë marr ngrykë shtëpinë
Për të nisur një jetë të re pas këtij pragu.
Të ëndërroj s’ma ndal dot njeri.
Të jem një tjetër pas këtij pragu duhet ta kapërdij.

HAPA TË MËSUAR

Jetoj në brendinë e një zhgualli të tejdukshëm.
Dal prej tij duke përsëritur rregullat.
“Çdo gjë që s’përsëritet, harrohet.”
As edhe një rregull s’e kemi të shkruar,
Po nëna m’i pat kënduar në djep.
M’i pat pëshpëritur kur më lante,
M’i pat dhënë t’i përpija bashkë me bukën.
“Ti, thoshte ajo, Je vajzë.
Këtë mbaje mend!”

Ç’më dallonte nga të tjerët?
Kisha frikë ta shoh trupin në pasqyrë.
Kisha frikë t’i flas mendjes sime.
Një pjesë e historisë më mungonte.
Kush ishte nëna ime, aq e largët nga trupi im?
Mendoja se vuaja nga harresa.
Kush isha unë?

Njeri kurrë s’më pyeti
Mjaftoi për ta trupi im,
Flokët e mia dhe zëri im femëror.

Jetoj brenda një zhgualli
çdo ditë që dal prej tij,
Përsëris me vete zërin që më thotë:
“Mos harro, bota është e ashpër për gratë!”

THYERJE E MOSHËS

Hava, Eva, Lilija,
Tashmë të plakura
Kanë brazduar vendin e tyre mbi shtrat
Dhe u bëhet sikur ngushtojnë botën.
Tashmë identifikohen me atë pjesë shtrati
që ka marrë formën e kurrizit të tyre të lakuar.

Ato teksa pleqërojnë stinët
Asgjë s’bëjnë, veç vriten përditë në mendime.
Kush ka faj në këtë mes?
Që vetëdijen s’dinin ta pranonin,
E tashmja qe një ditë për të pritur të ardhmen.

Pastaj,
E dini: punët, martesë, burri, fëmijët, shtëpia, bota,
këto duhet ta kishin bërë të ndjehet e plotësuar dhe në kohë,
Teksa ishte harruar fare për veten.

Një çast qe ai, shumë i shkurtër
Tek sa ajo pa dimrin mbi flokë,
Tek sa pa lëkurën e çarë si lëkura drurit të thatë.
Pastaj, e mësuar të harrojë shpejt
Shkoi, u krspullos te vendi i saj,

Hava, Eva, Lilija
A cilado qoftë prej tyre
Pleqëron në lëkurë
Teksa koha e saj rrjedh
Mbi sytë që janë bërë det
E ruan ujin e kripur të viteve
se s’kishte vend të saj as për të qarë...
Dhe pret, e urtë Dimrin e gjatë
mbi shtratin që ka marrë formën e trupit të saj...

JAM GRUA

Jam e ngjizur në dhë.
Jam trup i bukur, shëmbëlltyrë e një skulpture. Jam grua.
Jam më pak trup dhe më shumë shpirt.
Jam më pak lëkurë dhe më shumë ndjeshmëri.
Jam e shkathët në mendime.
Brenda tokës sime rriten sytha dhe lulëzojnë.
Trashëgoj pafund dashuri, ëndrra dhe pasiguri; n’fund-

t’fundit- Njeriun.

Jam e fuqishme. Marr dhe jap zemra. Marr dhe jap dhë në dhë.
S’më sheh kush në jam apo jo.
S’kam shtëpi, veç një dhomë, me një dritare sa sytë.
Hap sytë e mendjes, dhe sytë e zemrës qeshin.
Jam grua.
Tokë.
Botë.
Gea.
Jam me përbërje dheu dhe reje.
Jam pluhur që bartet e ngjizet nëpër drurë e lule,
e linden bletë, flutura dhe fëmijë
Që ngarendin pas tyre e po shkelin mbi barkun tim.

Jam gjithëpërfshirësja.
Jam gjithnjë shumë mendje e shumë zemër.
Jam ndjeshmëria e dritës mbi natën.

PERRITË

Ndër thellësitë e maleve
Nëpër tymin e oxhakut
Del mendimi fort i shqetësuar i tyre,

Se gruaja është e përkohshmja.
Kupto- Gruaja s’ka kohë.
Gruaja nuk është shtyllë,
po një kujdestare e orës
që mos ua lë unët sytë.

E fyti thahet nga këto mendime.

Ndër thellësitë e natës, ndër hijen e plepit,
Gruaja ëndërrohet si një Zanë Perit,
Që t’mallkon po i shkele mbi ma(n)gjen e saj- bukën,
Po nuk ia puthe bardhësinë e saj,
E po nuk ia krahasove fytyrën me bukë-urinë.

Po, burri ka uri për bukë, prandaj, gruan e quan Perri*.

Nën fytyrat e shqetësua të botës,
Vërehet fytyra e burrit atje prapa maleve,
Që e do bukën si të ishte shenjt,
Po duart që ia gatuan i sheh si rob.

Burri lëshon frymë,
E gëzohet pse është burrë
Vetëm nga pesha që e di se duhej të mbante
Po të ishte Perrni,
po të ishte Zana që ndër themelet e shtëpisë frymon.

Po, gruaja, i kanë thanë, është gjarpër,
e gjarpurin nuk guxojmë ta vrasim,
Se ai është mbrojtës i shtëpisë..

VDOR** E BARDHË

Zbardhet mali pas malit të syve,
Lulja fsheh kokën e turpërohet për hijeshinë e saj
Vjen acari dhe nata e enjte e gjen të bërë nuse,

Bardhësia dhe vdekja- një shtrat.

* Vdorë\ a- borë



RIDVAN DIBRA

Muri

Aty pak para mesnate, ndërsa gjumi nuk e zinte dhe trurin ia kishin pushtuar gjithfarë mendimesh, ndjeu një dëshirë të papritur ta përkëdhelte shpatullën e zhveshur të së shoqes. Kishte muaj të tërë pa provuar një dëshirë të tillë, ose diçka të përafërt me të. Gruaja foli diçka në gjumë, e nxitur kushedi nga çfarë ëndrre, dhe u kthye në shpinë. Drita e zbehtë e hënës shqyente me mundim perdet e rënda të dhomës së gjumit, bëhej bojë jeshil dhe binte pjerrtë mbi fytyrën e gruas. Ai pa me kureshtje sesi luante hëna në atë fytyrë, duke ia pohuar vetes se me të vërtetë kishte një grua të bukur. Kushedi sa kohë kishte pa e bërë këtë pohim. Sidoqoftë, ai kishte një grua të bukur, pavarësisht nga trillet e hënës, dhe sonte ndjente dëshirë ta përkëdhelte jo vetëm në shpatullën e zhveshur por edhe në fytyrën e jeshiltë (vetëm sytë aty dukeshin të zinj), në qafën e hollë, në gjoksin e vogël, gjithkund.

Zgjati dorën dhe pak pa prekur sytë e mëdhenj të gruas, ndeshi në diçka të fortë që tringëlliu si xham. U kujtua se gjithnjë e më shpesh, sidomos këto kohët e fundit, po bëhej rob halucinacionesh dhe qeshi lehtë. Ndezi abazhurin. Dhoma u mbush me dritë të kuqe, ndërsa jeshilja në fytyrën e gruas u bë e kafenjhtë. Gruaja ndjeu lojën e beftë të dritave në fytyrë dhe prapë foli diçka nëpër gjumë. Ai përsëri zgjati dorën drejt saj, por prapë ndeshi në diçka që tringëlliu si xham. U drodh lehtë. Tashti s’bëhej fjalë për kurrfarë halucinacioni: ai ishte i zgjuar, pranë kishte një grua të bukur që ishte e tija dhe, të cilën, kishte një dëshirë të çmendur ta përkëdhelte sonte. Kaq. Asgjë më shumë.

Zgjati dorën më poshtë kësaj radhe, drejt qafës së hollë e të bukur të gruas. Përsëri ajo pengesë e fortë me një tringëllimë si të xhamtë. U ngrit si i tërbuar nga shtrati dhe ndezi llambën e madhe. Dhoma u mbyt me dritë të bardhë, ndërsa te fytyra e gruas e kafenjta u bë e verdhë. Ajo flinte pa ndjerë përpëlitjet e dëshpëruara të burrit dhe atë betejë të heshtur e egoiste të ngjyrave në fytyrën e saj. Ai u vërsul ta puthte atë fytyrë që sonte ishte tmerrësisht e bukur dhe e pafajshme. Balli iu përplas fort për diku, buza e sipërme iu ça dhe mbi gushën e tij u sajua një vijë e hollë gjaku. Por ai sonte kishte vendosur ta puthte atë fytyrë, që ishte më e mrekullueshme se kurrë. Do ta thyente e do ta bënte copë e grimë atë mur të mallkuar si prej xhami. Mbylli sytë, ngriti grushtin e majtë dhe goditi furishëm. Priti të dëgjonte zhurmën karakteristike të qelqit të thyer, por në vend të saj dëgjoi veç një rënkim të lehtë dhe asgjë tjetër. Hapi sytë me një parandjenjë aspak të mirë. Fytyra e gruas ishte pranë tij, e tjetërsuar, me njolla gjaku e kristale të thyera gjithandej; ndërsa te sytë i lexohej një “pse?” e zbehtë.

Marrë nga “Eklipsi i shpirtit”, proza. 1994

EGLA XHEMALI

Greis

Jam vajza që ka ardhur nga Marsi. Po po, isha deri atje për të rrokur të fshehtat e sëmundjes sime. Më thanë se në një shishe ndodhej diagnoza, që mjekët në tokë nuk ma përcaktuan kurrë. U enda me ditë të tëra në pellgjet e mbushura me lot hëne, po më kot, hiçgjë. Pastaj diçka më trazoi kokën, kalova në jerm e papritur u gjenda këtu, mes këtyre bluzave që më kallin datën sa herë më afrohen.

– Greis e kalove të madhen, – më tha zëri mosbesues i burrit që ishte kthyer me shpinë nga dritarja. Nuk kisha dëshirë të dëgjoja tek më flisnin me keqardhje, madje fjalëve të tij as që u kushtova rëndësi.

– E di kuptimin e emrit tënd? Greis është hiri i perëndisë. Ti je vajzë e mbarë. Shumë shpejt do të shërohesh.

Për të mos u treguar e pasjellshme vura buzën në gaz. Kisha kaq kohë që endesha në udhëtime me datë të papërcaktuar për nisjen, e aq më tepër për kthimin. Ndihesha e lodhur. Dora më ishte mpirë nga vigoni që nuk e di sa ditë kishte në dorën e djathtë. Venat zmadhoheshin. Herë pas herë e shihja veten të lyer me gjak. Po, kur nata binte unë lutesha të mos flija. Dikur kisha qenë një romantike e sëmurë kur lexoja romanet kalorësiakë, arratisjet e princeshave, ndërsa tani kisha ndryshuar kryekëput. Oh, sa më mundonte gjumi! Këmbët më sfliteshin nga kilometrat e gjatë që bëja në mesnatë, megjithatë prapë ecja. Mbaj mend që para disa javësh kisha ikur për të mos u kthyer më. Atyre njerëzve me bluza të bardha u kishte ardhur keq, megjithëse, unë dëgjoja një të qeshur kumbuese teksa fluturoja në ajër. E kisha prekur shpeshherë blunë atje lart, mirëpo më merrte malli për mamane dhe kthehesha me siguri.

Nesër do të filloja terapinë. Ai tipi shpinëkthyer kishte ardhur përsëri në dhomën time.

– Terapia do të zgjasë disa ditë. Duhet të ushqehesh mirë. Ju të rinjtë bëni naze për ushqimin.

I hodha një shikim të shpejtë. Ai dukej aq i sikletosur kur nisja mjekimet, saqë mendoja se ishte më i sëmurë se unë.

– Kjo do jetë terapia e fundit, – i thashë. Pa kurrfarë dëshire zbulova krahun që kishte marrë ngjyrë manushaqeje nga vigoni. Bija erë ilaçesh. Kisha harruar aromat e luleve, madje dhe trëndafilat që kisha në dhomë mbanin erë barnash.

– Ke qenë më keq. Kjo do të jetë terapi e fortë. Do të ndihmoj të ngrihesh.

E shihja me sytë e mëdhenj mosbesues. Fjalët e tij më ishin bërë refreni më i dëgjuar i atij viti të mundimshëm. Kur nisa terapinë isha në gjendje kllapie. Nuk njihja askënd. Mbaj mend një fytyrë që qante e qeshte njëkohësisht. E vetmja që doja pranë dhe pse se dija kush ishte. Më vonë kur mendja u qetësua kujtova se ajo ishte mamaja ime. Kur zgjohesha një herë në dy ditë ndihesha shumë e këputur. Kockat sikur sa vinin dhe dobësoheshin, sytë thuajse më kishin dalë jashtë, mollëzave u kishte dalë roza që dukej kur qeshja dhe flokët kishin mbetur disa fije të holla fare. Isha deformuar. Kisha qenë një zonjushë e bukur, të paktën kështu më thoshin. Tani po kthehesha në një skelet që e mbante gjallë një terapi e stërmundimshme. Kur zgjohesha e ndieja veten përherë e më të rënduar. Të bardhët vinin herë pas herë në dhomën më të zymtë të atij burgu e jo rrallëherë bënin shaka të rëndomta me njëri-tjetrin. Kisha filluar të acarohesha shpejt. Nuk dëgjoja dot as zhurmat e hapave të tyre, e jo më zërin, që më dukej sikur buçiste nga mali. Një natë kisha ikur përsëri. Nuk kishin lënë rrugë pa më kërkuar, mirëpo nuk isha dukur askund. Një ngjyrë limoni më kishte spërkatur fytyrën dhe disa porcione akulli më kishin veshur trupin. Mbaj mend si në ëndërr një këngë me zë të mbytur, që më shoqëronte për lart. Terapia kishte ndaluar që kur po bëhesha gati të ikja. E kisha parandierë këtë, që kur ai shpëtimtari i tha mamasë se është rëndë, po që do të më shpëtonin. Unë brofa një moment nga frika. Në fyt më mbysnin dy duar të padukshme. Një vel i hollë mi përkëdhelte sytë. Mbi kokë ishte mami që dëneste teksa lutej për mua.

– Ma, erdha prapë, – i thashë. Ajo më puthi ballin e me lotët ndër sy më mori dorën në prehër.

– Edhe pak se do të ia dalim. Zoti është i madh!

Pashë ashtu nëpër mjegull se më kishin vënë një tub oksigjeni në hundë që më mbushte mushkëritë me ajër. Sa vinte dhe ndieja që po largohesh. Një grimë kohë kishte kaluar dhe mbi mua kishte rënë borë atë fund vere. Kisha vdekur duke pyetur si më quajnë. Mami më kishte thënë se shpirti i njeriut nuk vdes kurrë. Tani që jam këtu lart e shoh shtëpizën që më ka ndërtuar atje te kodra ndanë rruge. Mami vuan për hirin e perëndisë. Ajo ka harruar që ai nuk tretet kurrë.

ZEF ZORBA

Tjera blerime

-Terezës-

Si lule dyelli gjethet,
veshur me vapë e t’zberë

e nuk lëviznin...

e merrnin frymë me zor...

e... oh...

S’andejmi
ku paskeshin ngelur kujtesë brymore
zgjohen flauri
tjera blerime,
rinore.

(A të kujtohet? Atë verë
burimet heshtja na i trazonte.
këndoja vijat e fatit
në dorën tënde flakë.
Endeshim rrugësh të çuditshme,
pa folë.

Pastaj n’teatër: një Gjido
i larë në djesë
përpëlitej i falisur.
Ti shkuleshe ngaz me të madhe,
por në sy të vetëtinte
stuhia e Shtatorit...
A të kujtohet?)



VISAR ZHITI

Edës time në ditën e saj

Ikonë m’u bëre
me vështrim nga unë...
Fytyrë e ëndërrt me aureolë drite.
Jeta ime kishte rënë më gjunjë,
Me një qiri në dorë,
që po fikej...

Dhëmbjen e Shën Mërisë ta kuptova,
i shtangur përballë si kryqi.
E shkrete pa mëshirë dukej toka,
duhej marrë shpirt nga Qielli.

Më hoqe natë si pallton nga supet.
Të shuarin qiri
me lutjen ma ndeze.
Rrubarja e yjeve bashkë me puthjet
Të vezullonin në duart si mëngjeze.

Hijet qetësoheshin nga hijeshia jote
Dhe Hyu pëshpëriste fjalë malli.
Ishe ti që mua më mbrojte
nga braktisja fatale,
nga djalli.

Mama engjëlli, gruaja ime,
me breroren mahnitëse të diellit,
këngë në meshat pa mbarime
të dashurisë mes Tokës dhe Qiellit.

POEZI AMERIKANE

Përktheu Roland Gjoza

Walt Whitman

NJË MERIMANGË TINZARE DHE PA ZHURMË

Në merimangë tinzare dhe pa zhurmë
Ngul sytë në një cep ku ajo qëndron e izoluar
Ngulmoj të shoh si kërkon rreth e rrotull në një rreth
bosh e mjaft të gjerë
Si lëshon fije- fije fije pafund nga trupi i saj
Duke i bërë më të dukshme duke shpejtuar gjithnjë e
më shumë

Dhe ti, o shpirti im, atje ku qëndron
I shkëputur, i trishtë ne oqeanin e hapësirës
Parreshtur përpiqesh përmes pështjellimesh e
rreziqesh, gjersa të Bashkosh sferat me njëra -tjetrën
Gjersa të formosh urën, gjersa të kapësh spirancën
Gjersa fijet e merimangës të flakësh, o shpirti im!

Charles Bukowski

KUJTOJ NJË BUZËQESHJE

ne kishim peshq të artë dhe ata silleshin përqark
në një kupë mbi tryezë pranë perdeve të rënda
që mbulonin pamjen nga dritarja
nëna ime gjithmonë buzëqeshte dhe duke dashur që të
gjithë ne
të ishim të lumtur, më thoshte; "Ji i lumtur, Henri!"
dhe ajo kishte të drejtë; është më mirë të jesh i lumtur
në qoftë se mundesh
por babai vazhdoi ta rrihte atë dhe mua disa herë në
javë
i tërbuar brenda kornizës së tij 6 këmbëshe, sepse ai
nuk e kuptonte
ç'e shtynte nga brenda
nëna ime, peshk i gjorë,
priste te ishte e lumtur, dhe, ndërsa babai e rrihte dy
ose tre herë
në javë, më thoshte të isha i lumtur; "Henri, buzëqesh!
pse nuk buzëqesh kurrë?"
pastaj ajo do të buzëqeshte përsëri për të më treguar
buzeqëshjen më të trishtuar
që kam parë ndonjëherë
një dite peshqit e artë ngordhën, të pestë
pluskonin përqark
me sytë e hapur
dhe kur babai u kthye në shtëpi ai ia hodhi ata maces
atje në dyshtin e kuzhinës dhe ne shikonim nënën
që buzëqeshte

Emily Dickinson

SHPRESA ËSHTË DIÇKA ME PUPLA

Shpresa është diçka me pupla
Që në shpirt rri strukur
Këndon një këngë pa fjalë
Dhe nuk pushon kurrë

Dhe në Gale dëgjohet ëmbël
Mund të zemërojë stuhinë
Mund të trembet zogu i vogël
I strukur ngrohtë në shpirt

E kam dëgjuar në tokën me acar
Dhe në detin e çuditshëm
Kurrë në çastet më të vështirë
Nuk i kërkova një thërrime

Kim Addonizio

ÇFARË DO NJË GRUA

Dua një fustan të kuq
Dua të jetë i butë dhe i lirë
E dua shumë të ngushtë sa, kur ta vesh
të më dalin lotë dhe dikush të më shohë
E dua pa mëngë dhe shumë te hapur në shpinë
Po askush s'duhet ta marrë me mend
se ç'ka nën të. Pastaj dua të shkoj poshtë rrugës
të kaloj tregtizën me rroba të përdorura, më pas atë te
pajisjeve shtëpiake
me gjithë ata çelësa që shkëlqejnë në dritare
të kaloj zonjën dhe zotin Wong që shesin ëmbëlsira të
mbetura
në kafën e tyre, të kaloj vëllezërit Guerra
që tërheqin derrat nga kamioni dhe mbajnë kukullat
Dolly
që lëshojnë zëra dremitës, ledhatarë, mbi supet e tyre
Unë dua të eci
sikur te jem e vetmja grua në botë që kam bërë këtë
zgjedhje
E dua për vdekje
këtë fustan të kuq
Dhe dua të them me zë të lartë
se frika jote është më e keqja për mua
të tregoj gjithashtu se sa pak më intereson kujdesi yt
ose asgjë fare, përveç asaj
se çfarë une dua. Kur ta gjej, do ta tërheq atë veshje
nga varësja, sikur të kem zgjedhur një trup
që do të më fusë brenda, përmes
qarjeve të lindjes dhe klithmave të dashurisë
dhe unë do të vishem me kocka, me lekurë
me një fustan fantazmagorik do të vishem
dhe brenda tij do të varrosem

Sara Teasdale

YJET E DIMRIT

Dal fillikate kur vjen nata
Matanë detit derdhet gjaku i ri
Shpirtit atje i ngecën flatrat
Prej dhimbjes së rëndë që nxin

Por kur e ngrita kokën lart



Nga hijet mbi dëborën e bardhë
Unë pashë Orionin në lindje
Që digjej si shumë vite më parë

Nga dritarja e shtëpise së babait
Ëndërroja në netët e dimrit
E pashë Orionin si një vajzë
Mbi dritat e një qyteti tjetër

Shkuan vitet, ëndrrat, rinia
Zemra u thye në luftrat botërore
Gjërat ndryshuan, përveçse në lindje
Drita e Orionit ishte madhështore

Charles Wright

RIBASHKIM

Kjo ditë u shkëput nga të gjitha ditët e dikurshme
Ato janë në një fotografi brenda xhepit tim të butë
Fryma e atyre kohëve ngarkohet si një thes në shpinë te
erës dhe shkon në të kaluarën

Une shkruaj poezi për bashkimin e vetvetes, me
pendesë për atë që u zhduk
Nëpërmjet gishtërinjve të dorës së djathtë, në një cep,
bëj një lutje.

Carl Sandburg

BRODUEJ

Nuk do të harroj kurrë, Broduej
Arin tënd dhe dritat ulëritëse

Do të kujtoj shumë gjatë
lumin e mureve të lartë të nxitimit dhe lojës

Zemrat që të njohën dhe të urreyen
Dhe buzët që të dhanë të qeshurën
Janë bërë hi i jetës dhe trëndafila të saj
Ëndrrat e mallkuara që humbën
janë shkelur në gurët e tu të ashpër.

e.e. cummings

DIKU KU NUK KAM UDHËTUAR ASNJËHERË

diku ku nuk kam udhëtuar asnjëherë, gëzueshëm dhe
përtej
çdo përvoje, sytë e tu ruajnë heshtjen e kësaj të
panjohure,
në gjestin tënd më të imtë janë gjërat që më kanë
robëruar
të cilat nuk mund t'i prek sepse i kam fare pranë

vështrimi yt më i pavëmendshëm do të më mbyllë
brenda
megjithëse unë e kam mbyllur veten si gishtërinjtë
ti përherë më hap petale pas petalesh ndërsa pranvera
shfaqet
(duke prekur vrullshëm dhe misteriozisht) trëndafilin
e saj të parë.

në qoftë se ti dëshiron të më mbyllësh, jeta ime
do të shuhet në mënyrën më të bukur dhe krejt papritur
si zemra e këtij trëndafili teksa imagjinon dëborën
kur bie prej lartësisë me heshtjen e fantomës

asgjë që ne shohim në këtë botë nuk është e njëlojtë
pushteti i fuqisë tende është kaq i brishtë; sa kjo
më detyron me gjithë ngjyrat e vendeve që i përkasin
kësaj bote
të jap vdekjen time për ty në çdo frymëmarrje

(unë nuk e di çfarë të pëlqen që më mbyll dhe
më hap; vetëm diçka sigurisht unë e kuptoj
zëri i syve të tu është më i thellë se të gjithë trëndafilat)
dhe askush, madje as shiu, nuk ka duar kaq të vogla.


Lauren Marino

Dhoma më vete: Aty ku disa nga shkrimtaret më të mira krijuan art

Lauren Marino për hapësirat ku shkruan Virginia Woolf, Toni Morrison, Jane Austen, Maya Angelo, motrat Brontë dhe J.K. Rowling.

Virginia Woolf i parashtrroi qartë pikëpamjet e saj te “Një dhomë më vete”, ese e shtjelluar në një libër që përbëhej nga leksionet mbi “Gratë dhe letërsinë” leksione që ajo i mbajti në dy kolegje gjatë vitit 1928: “Një grua duhet të ketë para dhe një dhomë më vete nëse do t’i përkushtohet letërsisë”. Ajo mund të ishte idealiste, por për ne të tjerët, është e vështirë të gjesh një vend të qetë për të punuar pa u shpërqendruar, kurse paratë janë një çështje krejt tjetër. Atëherë, si i krijuan Woolf dhe shkrimtaret e tjera hapësirat ku ato shkruanin?

KËNDI I SHKRIMIT TË VIRGINIA WOOLF-IT



Kur Virginia dhe Leonard Woolf blenë shtëpinë “Monk’s House” në rrethinën rurale të Sussex-it, ajo e shndërroi një shtëpizë druri për vegla në kopsht në hapësirën e saj si shkrimtare. Në verë hynte shkëlqimin i diellit hynte përmes dritareve të mëdha dhe ajo mund të sodiste pamje mahnitëse. Për fat të keq, në dimër, ishte aq shumë ftohtë sa mezi mbante stilolapsin në dorë dhe përfundimisht ishte e detyruar të zhvendosej në shtëpinë kryesore. Ajo e shkroi *Zonja Dalloway* këtu, bashkë me shumë nga recensionet, esetë dhe letërkëmbimet e tjera, ashtu si edhe shënimin për vetëvrasjen që e shkroi për të shoqin, Leonardin.

DIVANI I TONI MORRISON-IT

Si botuese e palodhur e librit dhe nënë beqare e dy djemve, Morrison-i zgjohej herët dhe shkruante para se të shkonte në punë. Këtu është dhoma e saj e ndenjes e viteve 1970-të, ku ajo shkruante, e ulur në divan, shumë herët në mëngjes.



TRYEZË E VOGËL SHKRIMI E JANE AUSTEN-IT



Ishte kjo tryezë e vogël, e rrumbullakët, prej druri arre në shtëpinë Chawton Cottage që Jane rishikoi dorëshkrimet e romaneve *Mençuri dhe ndjeshmëri* dhe *Krenari dhe paragjykim* si dhe shkroi pjesën më të madhe të veprës së saj të mëvonshme. Gratë e tjera në shtëpi i mundësuan Jane-it vetminë dhe kohën për të shkruar, duke marrë përsipër pjesën më të madhe të punëve të shtëpisë dhe në kopsht, në mënyrë që të mund t’u përkushtohet atyre që përfundimisht do të bëheshin romanet e saj me famë ndërkombëtare dhe të dashur për lexuesit.


DHOMË HOTELI E MAYA ANGELOU-T



Angelou kishte një dhomë hoteli për vete në cilindo qytezë që jetonte, mbërrinte atje në gjashtë e gjysmë të mëngjesit dhe punonte deri në orët e para të pasdites. Nuk flinte asnjëherë në to, por e kishte zakon të shtrihej në shtrat me “një shishe verë, një fjalor, blloqe të verdha shënimesh, tavëll dhe një bibël”. Pastaj shkonte diku tjetër dhe përpiquej të jetonte si një njeri i zakonshëm deri në mbrëmje, kohë kur kthehej në dhomën e saj të hotelit dhe lexonte ato që kishte shkruar atë mëngjes duke e mbushur me nënvizime.

SALLONI I MOTRAVE BRONTË

Mobilje të lyer me ngjyrë jeshile, libra dhe një oxhak i ngrohtë e bëjnë këtë dhomë në famullinë e Haworth-it të rehatshme, por është edhe një hapësirë që të ngjall shumë aftësi krijuese, pasion, ndjenjën e melankolisë dhe humbjes. Portreti i Charlotte-ës i varur mbi oxhak




u porositi nga botuesi i saj pasi ajo u bë një shkrimtare jashtëzakonisht e sukseshme. Të tri motrat shkruanin në tryezën e madhe të ngrënies dhe ecnin nëpër dhomë duke diskutuar për veprën e tyre. Thuhet gjithashtu se Emily në ditët e saj të fundit nuk kishte fuqi për të ecur dhe vdiq te divani i kësaj dhome. Pasi vdiq Anne, kjo dhomë u bë pronë e Charlotte-ës, aty ajo redaktoi veprën letrare të motrave dhe u takua me zonjën Gaskell për të diskutuar biografinë e saj.

KAFENEJA E J. K. ROWLING



Kur J.K. Rowling ishte nënë e re e cila jetonte në gjendje mirëqenieje, kur filloi të shkruajë librat Harry Potter në kafenenë “Elephant House” në Edinburg ndërsa fëmija i saj dremiste. Duke mos mundur të vijonte e qetë shkrimin e librit të fundit të serisë vite më vonë, e shpërqendruar pareshtur dhe e paaftë për të punuar, ajo u regjistrua në Hotel Balmoral, gjithashtu në Edinburg, dhe, pas një dite jashtëzakonisht produktive u zhvendos aty për një muaj të tërë për ta përfunduar librin.



Shkëputur nga libri “Zakone letrare: Gra që shkruan atë që hyri në histori” nga Lauren Marino, ilustruar nga Alexandra Kilburn. Botuar nga Abrams Image, 2021.

Përktheu: Granit Zela

IKJA E POETIT LAWRENCE FERLINGHETTI

Më 22 shkurt, pak ditë para datëlindjes së tij të 102, ndërrroi jetë Lawrence Ferlinghetti. I njohur më së shumti si poet, veçanërisht falë vëllimit me poezi "A Coney Island of the Mind" (1958) i cili u përkthye në nëntë gjuhë dhe shiti më tepër se një milion kopje, Lawrence ishte edhe piktor dhe aktivist i të drejtave të njeriut, por mbi të gjitha, bashkëthemelues i "City Lights Booksellers & Publishers", këndit magjepsës të librave në San Francisko. Në 2019, ai botoi librin e tij të fundit, romanin "Little boy" dhe po atë vit, me rastin e 100 vjetorit të lindjes, qyteti i San Franciskos vendosi ta kremtonte çdo datë 24 mars, datëlindjen e tij, si Dita e Lawrence Ferlinghetti- t.

Ndonëse ai asnjëherë nuk e pranoi, qysh në krye të herës, personaliteti i tij letrar u bë vetvetiu pjesë e Beat Generation, lëvizje letrare e zhvilluar në Amerikën e pasluftës. Thelbi i saj që refuzimi i vlerave standarde të rrëfimit, kërkimi i vlerave shpirtërore, eksplorimi i besimeve të lindjes, refuzimi i ekonomisë materialiste, eksperimentimi me drograt psikodelike, liberalizimi i seksualitetit e të tjera. Përkrah tij, të tjerë emra të njohur që u bënë pjesë e saj ishin edhe Gary Snyder apo Neal Cassady. Me të drejtë, humbja e Lawrence u cilësua edhe si pika e kthesës së kësaj lëvizjeje: nga e gjallë dhe aktive, në pjesë të historisë, ndonëse për të vijon të shkruhet.

New York Times e quajti Lawrence Ferlinghetti "gjyshi shpirtëror i Beat Generation". Neeli Cherkovski, poet amerikan, para pak vitesh botoi librin e tij "Elegy for the beat generation" në të cilin trajtohen, nëpërmjet vargjeve, motivi, arsyeja dhe ndikimi i lëvizjes.

Por gjithsesi, qoftë disa nga kritikët dhe poetët, qoftë edhe vetë ai, sikurse e thamë, herë pas here nuk binin dakord me përcaktimin që i bëhet si pjesë e Beat Generation. Në një intervistë të dhënë në vitin 1951 për The Independent, mes të tjerash Lawrence thotë: "Në njëfarë mënyre, gjithçka bëra që në të mirën e dyqanit... Kur erdha në San Francisko në 1951, kisha veshur një beretë. Nëse isha diçka, mund të isha bohem, më shumë se i pari i Beats."

Gjithsesi për t'u rikthyer te Lawrence. Përgjatë 101 viteve të tij, ai ia doli të frymëzonte breza të tërë artistësh dhe shkrimtarësh në San Francisko. I lindur në 1919, në mes të Luftës së Parë Botërore, ai që i fundit ndër pesë fëmijë. I ati, emigrant italian i cili ia kish' dalë të ngrinte një biznes të vogël, e shkurtroi mbiemrin e familjes në Ferling, ndryshim i cili u zhbë më vonë nga Lawrence. I ati i vdiq kur e ëma ishte akoma shtatzënë, ndërsa e ëma u mbyll në një spital psikiatrik kur Lawrence ishte veçse dy vjeç.


Ferlinghetti u rrit nga një e afërme të cilën në librat e tij e quan Teto Emily, ndonëse lidhja familjare me të që e ndërlikuar. Pranë saj, ai shkoi në Salzburg ku mësoi frëngjishten para anglishtes. Kur u rikthyen në Shtetet e Bashkuara, u strehua përkohësisht në një jetimore, ndërkohë që Teto Emily po kërkonte për punë. Gjithçka ndryshoi kur ajo filloi të punonte si guvernante në shtëpinë e Bislandëve, një çift i kamur që jetonin pranë Bronxville, New York. Ato qenë të parët që panë një të ardhme te djali i mitur.

I lënë në kujdesin e tyre, Lawrence lulëzoi. Sipas biografisë së tij, përgatitur më 1990 nga Barry Silesky, ai u bë një lexues i paepur, tejet i etur për klasikët të cilët i lexonte në Bibliotekën e Brislantit. Për çdo poemë epike që mësonte përmendësh, fitonte dollarë të argjenditë. Në adoleshencë, e dërguan pranë Mount Hermon, një kolegji tejet strikt për djem në Masaçusets.

Me të përfunduar aty, ndoqi universitetin për gazetari në Karolinën e Veriut, ku edhe u diplomua. "Mësova si të shkruaj një fjali të denjë!" thotë ai, lidhur me ndikimin që pati gazetaria në poezinë e tij. Arsyeja pse zgjodhi pikërisht atë universitet ishte se edhe Thomas Wolfes, një ndër idhujt e tij në letërsi, pati studiuar pikërisht aty.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shërbeu si oficer i marinës detare, më së shumti në ujërat e Atlantikut të Veriut. Kur lufta mbaroi, u rikthye në universitet, tani në Kolumbia ku edhe mori masterin për Letërsi Angleze. Mikroteza e tij ishte për John Ruskin dhe artistin J. M. W. Turner, njeriu i cili i dhuroi dashurinë e përjetshme për pikturën. Pas Kolumbias shkoi në Paris, "dheun e bohemëve të pasluftës" ku përfundoi studimet doktorale në letërsi të krahasuar në Sorbonë.

Në fillim të 1951, u rikthye në Shtetet e Bashkuara, tanimë në San Francisko. Kishte me vete veç një çantë dhe pakogjë tjetër. Pas muajsh të tërë në një apartament me qira të lirë, ai zbuloi Plazhin e Veriut (North Beach) njëkohshëm me ndryshimin e shpejtë që po pësonte San Francisko me modernizimin mes intelektualëve dhe brezit të ri për të cilët "establishmenti" ishte një fjalë e ndyrë.



"E gjitha kjo që bohemi!" pati thënë diku Lawrence.

Jeta e Lawrence Ferlinghetti-t ndryshoi kur në 1953, Peter Martin çeli City Lights Pocket Book Shop e cila, për hir të së vërtetës, nuk mbante brenda asgjë tjetër përveçse thasë plot me letra në një kohë kur industria e botimeve po bëhej një ndërmarrje gjithnjë e më serioze. Shpejt, dyqani do të kthehej në një ambient për librat që libraritë e tjera nuk i pranonin dhe në një strehë për autorët e tyre – një vend "ku mund të gesh ato libra që s'i gjen askund tjetër" sikurse Lawrence tha një herë.

Nga viti 1955, ai filloi të botonte edhe libra me poezi nën të njëjtën logo, City Lights përfshirë edhe librat e tij. Një vit më pas, City Lights botoi edhe "Howl and other poems" të Ginsberget, libër i cili ngjalli reagime të shumta. Fakti që "Howl" (Ulërima) përmbante referenca të qarta për drograt dhe seksin, qoftë ai heteroseksual apo homoseksual, çoi në burgosjen e Lawrence si botues i librit. I mbështetur edhe nga Bashkimi Civil Liberal i Amerikës, ai e fitoi gjyqin dhe u shpall i pafajshëm, ndonëse nëntë ekspertë të letërsisë dhanë dëshmitë e tyre rreth përmbajtjes së poemës.

Lawrence Ferlinghetti nuk ishte vetëm poet. Përgjatë viteve, ai punoi edhe në fusha të tjera si piktura apo teatri: një program teatral i përbërë nga tri drama të shkruara nga ai, u vendos në skenë në New Yorkun e vitit 1970. Por poezia mbetej dhe mbeti deri në fund të jetës arti më pranë zemrës së tij.

Përgjatë viteve, Lawrence mori një sërë çmimesh dhe nderimesh, ndër më të rëndësishmit në Amerikë. Por gjithashtu, edhe këndi i librarisë së tij City Lights u bë gjithnjë e më i njohur. Kur filloi pandemia e Covid – 19, ajo nisi një fushatë online për të mbledhur fonde, pasi tha se për shkak të situatës, rrezikonte seriozisht të mos hapej më. Në vetëm katër ditë, u mbledhën 450000 dollarë.

Edhe kur e ndjente fundin pranë, për shkak të moshës kryesisht, Ferlinghetti nuk reshti së shkruari poezi. Në vitin 2017, ai botoi "Ferlinghetti's Greatest Poems" ku përfshiheshin edhe krijime të reja.

"Poezitë e mia të reja" – thotë Ferlinghetti në një intervistë "janë gjithmonë poezitë e mia të preferuara."

Në gjuhën shqipe, Lawrence Ferlinghetti ka ardhur tejet pjesërisht. Sipas katalogjeve të Bibliotekës Kombëtare, rezulton se prej tij janë vetëm pak poezi të përkthyer, botuar në gazeta e revista, por akoma asnjë prej librave apo përmbledhje me poezitë e tija nuk ka ardhur e plotë.

Gjithsesi, shuarja e tij nuk kaloi pa u vënë re. Shkrimtarja e njohur Elvira Dones shkroi:

Nga sot, San Francisko nuk e ka më Lawrence. Duke kaluar pranë shtëpisë së tij, do të vendosin lule para libarisë City Lights. Do të doja të isha aty. Thank you Lawrence! Oh well, Thank You!

Edhe të tjerë njerëz të letrave si shkrimtarët Xhevdet Bajraj apo Shpëtim Selmani, studiues si Gëzim Aliu apo redaktorë si Aida Baro e kujtuan, në mënyrat e tyre, humbjen e tij.





A është “Ana Karenina” një histori dashurie?

Joshua Rothman
The New Yorker

Përktheu nga anglishtja Engjëllushe Shqarri

Para disa javësh, një të mërkurë me borë, bashkë me time shoqe shkua të shihnim versionin e ri të filmit “Ana Karenina”. Ishte premiera e filmit që po shfaqej në Nju Jork dhe, përpara se të fillonte, regjisor i tij Joe Wright, një anglez me flokë të zinj, veshur me një kostum ngjyrë gri, u ngrit për të thënë dy fjalë. Ai prezantoi Keira Knightley-n e cila luan Anën, bashkë me aktorët që luajnë Kitin dhe Levinin, Alicia Vikander dhe Domhnall Gleeson. Wright-i foli singlerisht, si vëllai më i madh krenar, duke thënë se me Knightley-n ka nisur të punojë që me filmin “Krenari dhe Paragjykimet” kur ajo ishte vetëm një “rioshe pa përvojë”. Ndërkohë, tha, filmi i tij i ri, “Ana Karenina,” ishte një film për dashurinë dhe për të gjitha mënyrat me të cilat dashuria na bën njerëzorë. Wright-i dhe aktorët e tij ikën pa u ndier nga një derë anësore dhe filmi filloi.

“Ana Karenina” e Wright-it nuk është një përshtatje e drejtpërdrejt e romanit, por një interpretim i ri fantastik, impresionist i tij, me skenar të mirë-informuar, të vetëdijshëm nga Tom Stoppard. Skenat janë krijuese dhe metaftikive. Knightley e luan Anën me një sensualitet nervoz; gara me kuaj e Vronskit është e gjallë dhe e frikshme; ndërsa historia e Levinit me Kitin, e këndshme, e duruar, madje edhe shpirtërore. Megjithatë,—kur e njeh dhe e dashuron romanin, në film ka diçka që të duket se nuk është tamam siç duhet. Problemi, mendoj, është se filmi është tepër romantik. Sikundër Wright-i premtoi, ai është i gjithë për dashurinë, por “Ana Karenina” e Tolstoit nuk është një histori dashurie. Në mos tjetër, “Ana Karenina” është një paralajmërim kundër mitit të kultit të dashurisë.

Kur fillova ta lexoja librin “Ana Karenina,” dhjetë vite më parë—jam i fiksuar pas këtij libri dhe e kam

lexuar shtatë herë që atëherë—edhe unë ashtu mendova se ishte, një histori dashurie. Asokohe ishte njëzetë e tre vjeç dhe mendoja të martoheja; për mua, ishte e qartë se romani ishte për dashurinë, të mirë dhe të keqe, të mençur dhe jo të mençur. E lexova romanin siç mund të lexojë njeriu çdo roman mbi martesën dhe tradhtinë bashkëshortore. Mendon për protagonistët dhe zgjedhjet e tyre; shpreson për një fund të lumtur. Kur fundi i lumtur vjen, duartroket dhe të duket se është i merituar; ndërsa kur nuk vjen, përpqesh të gjes se ku gabuan të dashuruarit. Por, kjo ide rreth dashurisë, e mbështetur mbi një histori dashurie, nuk është vërtet karakteristike e romanit “Ana Karenina.” Kur Tolstoi e shkroi romanin, kishte një mendim të ndryshëm për dashurinë: si një lloj fati, mallkimi, apo gjykimi dhe si një vektor përmes të cilit universi shpërndan lumturinë dhe hidhërimin në mënyrë të padrejtë dhe, me sa duket, krejtësisht të rastësishme.

Këto mendime nuk janë shumë romantike, por janë tolstojane. Kur u ul të shkruante “Ana Kareninën”, nuk është se Tolstoi thjesht i hodhi pas shpine temat e “Luftës dhe Paqes”. Përkundrazi, ai gjeti një mënyrë të menduari rreth të njëjtave çështje që i kishin interesuar gjithnjë—fati, rastësia, pafuqia për t’iu kundërvënë rrethanave dhe vendosmëria për t’i ndryshuar ato—në një kontekst të ndryshëm. Në 1873, kur Tolstoi nisi të shkruante “Ana Kareninën”, ishte duke planifikuar shkrimin e një romani historik mbi Pjetrin e Madh. Që nga 1870, ai ishte mbyllur në studion e tij në Jasna Poliana, duke lexuar e mbajtur shënime, ndërsa e shoqja dhe pjellat e tij të shumta rrekeshin të mos bënin zhurmë përjashta. Pjetri i Madh doli një temë tepër epike edhe për Tolstoin vetë. (“Jam gjithë nerva,” - do t’i shkruante ai një miku. “Nuk po më ecën puna fare. Projekti që kam zgjedhur është jashtëzakonisht i vështirë. Studimet paraprake nuk

kanë të sosur, skica e tij po më del duarsh dhe e shoh që fuqitë po më lënë.”) Tolstoi i duhej një subjekt më i përballueshëm. Dhe befaz, zbuloi diçka: një rrugëdalje nga shqetësimet e tij që nuk ishte shumë pretenduese dhe historike, por personale, intime dhe e trishtuar. Në biografinë e tij të Tolstoit, Henri Troyat e shpjegon kështu origjinën e romanit:

Befaz, diçka i ndriçoi në mendje. Iu kujtua një ndodhi që e kishte prekur thellë një vit më parë. Një fqinj dhe mik i tij, Bibikovi, gjuetar shapkash, jetonte me një grua të quajtur Ana Stepanovna Pirogova, një grua shtatlartë, e bëshme, me një fytyrë të gjerë dhe me një natyrë të shkueshme, e cila ishte bërë e dashura e tij. Por, kohët e fundit, e kishte shpërfillur për shkak të kujdestares gjermane të fëmijëve të tij. Madje e kish ndarë mendjen të martohej me zonjushën blonde. Kur e mësoi pabesinë e tij, xhelozia e Ana Stepanovnës nuk njohu kufi. Iku andej, duke marrë me vete një dëng me tesha e duke u endur nëpër fshatra për tre ditë, mendjeikur nga dëshpërimi. Pastaj, u hodh poshtë një treni mallrash në stacionin Jasenki. Përpara se të vdiste, i dërgoi një pusullë Bibikovit: “Ti je vrasësi im. Qofsh i lumtur, aq sa një vrasës mund të jetë i lumtur. Po ta duash kufomën time, mund ta shohësh në shinat e trenit në Jasenki.” Kjo ndodhi më 4 janar 1872. Ditën e nesërme, Tolstoi shkoi në stacionin në fjalë për të parë autopsinë që po i bënin në praninë e një inspektori policie. Teksa qëndronte në një qoshe të dhomës, shihte me vëmendje çdo detaj të trupit të gruas së shtrirë mbi tavolinë, të gjakosur dhe të gjymtuar, me kafkën e thërrmuar. Sa i paturp, mendoi, e megjithatë sa i dëlirë. Ai trup i bardhë, i zhveshur, ato gjinj të vdekur, ato kofshë pajetë që kishin dhënë e marrë kënaqësi i dhanë një mësim të tmerrshëm. U orvat të përfytyronte jetën e asaj gruaje të gjorë që kish dhënë gjithçka për dashurinë, vetëm e vetëm për të pasur një vdekje të tillë të rëndomtë, të shëmtuar.

¹ Pride and Prejudice, film i mbështetur në romanin me të njëjtin emër të Jane Austen-it.

Besoj se këtu ka një histori dashurie, por ajo që i interesoi Tolstoi nuk ishte dashuria, në vetvete, por pasojat ekstreme të saj. Kur Tolstoi nisi të shkruante librin “Ana Karenina”, ai futi personazhe dhe histori të tjera në të, përfshirë historinë e dashurisë së Kitit me Levinin. Por, në thelbin e saj, “Ana Karenina”—pa balsamin e historisë romantike të Kitit dhe Levinit—është një histori e trazuar për shkak të asaj që i ndodhi Ana Stepanovnes. Kjo e bën atë të ndryshme nga historitë e tjera të dashurisë – ku dashuria është diçka pozitive. Kur e ke, je i gëzuar, ndërsa kur nuk e ke, nuk je. (Mendoni për Lizi Benetin dhe Sharlota Lukasin tek “Krenari dhe Paragjykime”). Tek “Ana Karenina,” dashuria mund të jetë mallkim dhe bekim njëherazi. Ajo është një forcë esenciale në punët e njerëzve, si gjenia, apo zemërimi, fuqia apo pasuria. Ndonjëherë është e mirë, por ndonjëherë është e tmerrshme, mizore, madje, edhe e rrezikshme. Është një mrekulli që Levinin dhe Kiti bien në dashuri me njëri tjetrin—por për Anën do të kish qenë shumë më mirë nëse nuk do kish rënë kurrë në dashuri me Vronskin.

Ky mendim rreth dashurisë tingëllon bukur, në teori, por në praktikë, e kemi të vështirë ta pranojmë, sepse bie ndesh me mitologjinë e dashurisë, e cila i sheh dashnorët e rënë në dashuri si më romantikë, më të dashuruar se ne të tjerët. Kjo mitologji na shtyn ta shohim vdekjen e Anës si një sakrificë fisnike, kështu na pëlqen të themi. Themi se ajo dha gjithçka për të provuar dashurinë. Kjo është një mënyrë joshëse, por e marrë së menduari. E vërteta është se asgjë e mirë nuk vjen nga dashuria e Anës dhe Vronskit dhe se të gjithë do të ishin ndier më mirë po të mos kish ndodhur. Lidhja e tyre ishte pa dyshim një fatkeqësi për Anën, por edhe për Vronskin, për Kareninin dhe për Serjzhën, djalin e tyre. Gjatë dhënies së lëndës së romanit, kam parë studentë që orvaten t’i përvidhen këtij përfundimi; shumica e bëjnë këtë me anë të kundërfakteve. Disa argumentojnë se Ana nuk kishte pse të kryente vetëvrasje; se gabimi qëndron tek vetëvrasja, jo marrëdhënia e dashurisë, thonë. Por, edhe pashmangshmëria e rrethanave të Anës mund të shtrohet për diskutim. Mund të thuhet se Ana shkon deri në vetëvrasje për shumë arsye historike: ligje që paragjykojnë gratë, ndalimi i divorcit nga feja, një sistem njohjeje që i shtyn vajzat të martohen në moshë tepër të re dhe kështu me radhë. Mund të argumentohet se Anës i doli për keq, por faji nuk ishte i saj – nëse gjërat do të kishin qenë ndryshe, ajo dhe Vronski mund të kishin qenë të lumtur. Por, ashtu si qenë, gjërat nuk ishin ndryshe për Anën. Ligjet ishin të padrejtë, por tekefundit, kishte ligje. Sikundër thotë gjyshja ime çifute: “Ajo që është, është”. “Ana Karenina” paraprihet nga një citim shqetësues, i pa autor, epigrafi: “Hakmarrja është imja; unë do ta shpaguej.” Kjo është në një farë mase, ndjenja që shoqëron vetëvrasjen e Anës. Por, nga këndvështrimi i Tolstoi është gjithashtu një deklaram faktik rreth universit. Ai nuk luan nga vendi. Ajo që është, është.

Nëse Ana nuk është heroina e romanit—nëse nuk është martire e dashurisë—atëherë, çfarë është? Vendimi për atë që Ana është, përbën një nga vështirësitë kryesore të romanit “Ana Karenina.” Disa lexues, ndoshta nga që ndihen të tradhtuar nga Ana, fillojnë e vënë në pikëpyetje karakterin e saj, gjykimin e saj, apo motivet e saj. Të pazotë ta shohin atë si të mirë, përfundojnë duke e parë si të keqe. Keira Knightley, në një intervistë të regjistruar për premierën e filmit në Nju Jork, duket se është e këtij mendimi: “Për sa i takon historisë së Ana Kareninës, - thotë ajo, “shumica e njerëzve, në pjesën më të madhe të adaptimeve – dhe unë nuk i kam parë të gjitha – e kanë parë Anën si heroinë dhe të pafajshme, një lloj krijese që i është bërë padrejtësi nga bota, nga i shoqi, nga shoqëria, nga gjithçka. Kur e lexova librin herën e fundit, nuk mendova tamam ashtu. Mendoj se këtë mund ta thuash edhe lidhur me Anën. Por, mendoj



se ajo është edhe anti-heroinë.” Knightley e luan Anën si të ishte disi e ligë. (Disa njerëz krijojnë idenë se ka tepër epsh dhe jo aq dashuri, në marrëdhënien e saj me Vronskin, luajtur nga Aaron Taylor-Johnson). Por, gjithqysh, fjala anti-heroinë mund të ishte një term shumë i fortë për Anën. Tolstoi, sikundër ka vënë në dukje kritiku Gary Saul Morson, është i ndjeshëm ndaj faktit se një pjesë e madhe e të keqes në botë vjen jo nga ligësia, por nga padija. Ana bën gjëra të këqija, por shpesh vetëm sepse e nënvlerëson se sa të këqija janë pasojat e këtyre gjërave. Ana nuk e bën me plan të bjerë në dashuri me Vronskin, si qëllim në vetvete – ajo nuk është ndonjë lëneshë në kërkim të një mashkulli – dhe një prej arsyeve për hidhërimin që ajo ndien më pas është se, pasi fle me të, ndihet e zhgënjyer. Në episodin e parë të romanit (dhe të

filmit), Ana udhëton drejt Moskës për të pajtuar të vëllait Stiva dhe gruan e tij Dolli, të cilën ai e ka tradhtuar. Duke u larguar prej tyre, ajo mezi pret të kthehet përsëri në familjen e saj në Shën Pjetërburg: “Lavdi Zotit,” mendon, “nesër do të shoh Serjzhën dhe Aleksei Aleksandroviçin dhe jeta ime e mirë dhe e zakonshme do të vijojë si më parë.”

Ana, sugjeron Tolstoi, është si një rojtar që e shtyp trenin në fillim të romanit: “I dehur, apo tepër i mbështjellë me tesha për shkak të të ftohtit të acartë,” ai nuk e dëgjon afrimin e trenit. Marrëdhënia e saj me Vronskin është më pak një histori dashurie dhe më shumë një tragjedi e përcaktuar nga fati. Dhe Tolstoi bën kujdes që të tregojë se e njëjta gjë, por në anën e kundërt, vlen edhe në rastin e Levinin dhe Kitit, të cilëve u qëllon të jenë fatlum aty ku Ana është fatkeqe. Mësojmë se Levinin ka dashuruar dy motrat më të mëdha të Kitit; por siç erdhën punët, ato u martuan me burra të tjerë (njëra prej tyre, Dolli, me Stivën). Po të kishin rrjedhur punët ndryshe, Kiti mund të kishte përfunduar e martuar me Stivën dhe jo Levinin, dhe Levinin me Dollin. Në një çast, duket sikur Levinin është gati të heqë dorë plotësisht prej Kitit; por, pikërisht në atë moment, karroca e Kitit qëllon që kalon pranë fushës në të cilën po shëtiste Levinin, në thellësi të fshatit. Gjithashtu, është fakt se Levinin dhe Kiti mund të mos kishin përfunduar fare bashkë po të mos qe Ana, e cila ia rrëmben Vronskin Kitit në një ballo në faqet e para të romanit. Gati si provokim, Tolstoi e vendos këtë fakt—tradhtinë bashkëshortore të Anës që shtrun rrugën për martesën e lumtur të Levinin me Kitin – në qendër të romanit të tij, si një kujtesë e pagojë dhe ironike e faktit se sa shumë sukseset tona mund të varen nga fatkeqësitë e të tjerëve.

Besoj se Tolstoi nuk e di me saktësi se çfarë të mendojë lidhur me rolin e Anës në shkatërrimin e saj, njëlloj sikurse nuk e di me saktësi se çfarë duhet të mendojë për vullnetin e lirë të ushtarëve dhe gjeneralëve tek romani “Lufta dhe Paqja”. Ai beson se ne mund të bëjmë zgjedhje dhe se vullneti ynë i lirë mbështetet në diçka reale. Por, njëkohësisht ai ka një respekt të thellë për kompleksitetin dhe forcën e rrethanave ku ndodhemi, prandaj edhe



personalitetet dhe psikologjitë tona i konsideron gjithashtu “rrethana”. Ka kufi për ato që mund të bëjmë në botë dhe po ashtu ka kufi për atë që mund të ndiejmë, durojmë, dimë dhe përfytyrojmë brenda vetes. Këta kufi të brendshëm mund të jenë po aq të përhershëm sa ata të jashtmit. Në rastin e Anës, ajo mund të jetë ndier nën trusni nga të gjitha anët: e shtyrë në shpirtin e saj të dashuronte Vronskin, ndërkohë që jetonte në një botë që e bënte të vepruarit në bazë të asaj dashurie një veprim të pamenduar dhe të padurueshëm. Ose, ajo mund të kish bërë një zgjedhje të pamenduar, duke u dhënë pas dëshirave të cilat mund t’i kish mposhtur, sepse e nënvlerësoi se sa e palëkundur do të tregohej bota. Nuk kemi për ta mësuar kurrë atë që ndodhi, ashtu si Ana vetë nuk mund ta dinte. Ky është një nga mësimet e frikshme të historisë së Anës: ajo nuk ishte në gjendje të bënte dallimin midis asaj që po zgjidhte të bënte dhe asaj që ishte e shtyrë të bënte. Në jetë, ndonjëherë heqim dorë prej lirisë shumë shpejt, ndërsa, në raste të tjera, luftojmë pa u treguar të mençur përpara ligjeve që nuk ndryshojnë. Dorëzohemi tepër shpejt dhe endemi gjatë gjithë jetës; luftojmë tepër shumë dhe vuajmë për këtë.

Pas vdekjes së Anës, pjesa më e madhe e fundit të romanit i kushtohet Levinit, i cili orvatet të pranojë se sa pak ka ndikuar në lumturinë e tij. Levini është i pëlqyeshëm, i kujdesshëm dhe i sinqertë, por jo shumë i mençur, me përvojë, apo i mprehtë, (e shoqja e Tolstoit, Sonia, i tha Tolstoit se Levini ishte “ti vetë, por pa talentin tënd”). Ai ngjason me Anën në atë që pjesën më të madhe të kohës në roman e kalon duke diskutuar hapur dhe qëllimisht rreth të njëjtave çështje me të cilat përballet edhe Ana. A duhet ai të orvatet t’i bëjë njerëzit dhe institucionet rreth tij të ndryshojnë, me qëllim që të mund të jetojë me diktatat e shpirtit (për shembull, duke e ribërë fermën e tij më “moderne”, nga pikëpamja politike dhe bujqësore)? Apo duhet t’i dorëzohet ndonjërës prej mundësive të parapërcaktuara që ofron bota e tij dhe të bëhet një zotëri fermer krejtësisht konvencional? Për shkak se është një burrë i pasur, i pavarur, risku për të është më i vogël se për Anën, por përsëri i konsiderueshëm: Levini e ndien se asnjë nga mënyrat e zakonshme të

jetës nuk do të ketë kuptim për të dhe ai nuk do që jeta e tij të jetë e pakuptimtë.

Por, në rastin e Levinit ndodh që për shkak të një rastësie temperamenti dhe rrethanash, ai arrin t’i gjejë rrugëzgjidhje. Ai lufton dhe e drejton fatin e tij aq sa për të qenë i lumtur, duke mos i tejkaluar kurrë kufijtë dhe përfunduar si Ana, apo si vëllai i tij Nikolai, një radikal politik, i cili vdes i varfër dhe i zemëruar. Në një farë mënyre, gjatë zhvillimit të romanit, Levini arrin gjithçka që dëshiron: martohet me Kitin dhe kanë një familje të mrekullueshme. Por, megjithatë, ai e ndien se nuk e ka përmirësuar vërtet shpirtin e tij dhe se nuk ka bërë kurrëgjë për ta merituar atë lumturi. Vazhdon të ndihet i pafuqishëm, i pakuptim, i padobishëm. “I lumtur me jetën familjare,” shkruan Tolstoi, “i shëndetshëm, Levini disa herë shkoi kaq afër vetëvrasjes sa që e fshihte litarin nga frika se mos varej me të dhe trembej të dilte me një pushkë nga frika se mos vetëvritej.” Në fund, e rrëmben rryma e jetës dhe vijon të jetojë. E gjen rrugën e tij në një lloj besimi të përhapur. E kupton se nuk ka për të përjetuar ndonjë transformim rrënjësor, qoftë romantik apo fetar. Ajo që është, është. Do të përpiqet të bëjë më të mirën si një njeri i mirë, brenda kufizimeve që rrethanat dhe natyra i kanë vendosur dhe kjo do të jetë më se e mjaftueshme:

“Do të zemërohem njëlloj me karrocier Ivanin, do të argumentoj në të njëjtën mënyrë, do të them atë që mendoj pa pyetur nëse është mirë apo jo, do të kem të njëjtin mur midis skutës më të shenjtë të shpirtit dhe njerëzve të tjerë, edhe me time shoqe; do ta akuzoj atë njëlloj nga frika që ndiej dhe pastaj do pendohem, do të vazhdoj njëlloj të mos kuptoj arsyen se përse lutem, e megjithatë do të lutem – por tani jeta ime, e gjithë jeta ime, pavarësisht nga gjithçka që mund të më ndodhë, çdo minutë e saj, jo vetëm që nuk do të jetë më e pakuptimtë, siç ka qenë më parë, por do të ketë kuptimin e padiskutueshëm të së mirës që unë do të kem mundësi të fus në të”!

Romani na lë me një përgjigje që është njëherazi edhe një enigmë. Përse Levini mundi ta gjente këtë paqe, ndërsa Ana, jo? Vetë mënyra se si Levini e kupton këtë, na sugjeron se nuk ka një përgjigje për

atë pyetje. Tek libri “Iriqi dhe Dhelpra”² Isaiah Berlin shkruan se, për Tolstoin dituria përbëhet nga aftësia për të “kuptuar atë që vullneti dhe arsyeja njerëzore mund të bëjnë dhe atë që nuk mund të bëjnë”. Mënyra e vetme për t’i gjetur këta kufij është të ndeshesh me ta, por me butësi, me qëllim për t’i gjetur e pranuar. Nuk mund ta gjesh rrugën deri te kufijtë me anë të mendimit. Rrugën deri aty duhet ta ndiesh, duke mësuar përmes përvojës dhe vuajtjes. Por, ka një risk në eksperimentimin me atë që mund të funksionojë apo jo në jetë, i cili është se mund të mos funksionojë. Mund të zhvendosesh në Nju Jork, për të ndjekur ëndrrat e tua, dhe të përfundosh pa asnjë karrierë për të qenë. Mund të mendosh të presësh deri sa të gjesh gruan ideale, por pret tepër gjatë dhe përfundon vetëm. Mund të duash të kesh një lidhje dashurore, por të mbash edhe dashurinë e bashkëshortes dhe të fëmijëve – por mund të gabohesh lidhur me atë çka është e mundur dhe të humbasësh gjithçka.

Kjo mënyrë të menduari është tepër konservatore. Është fataliste në mënyrë topitëse, sepse sugjeron që kufijtë e të mundshmes nuk mund të dihen paraprakisht, dhe se përvoja dhe tradita mbase janë udhëzuesit më të mirë. Në rastin e Anës, ajo sugjeron se Ana duhet të ish përpjekur më shumë për të pranuar martesën e palumtur me Kareninin. Por, nëse ajo e kish provuar këtë, por e kish parë veten të mbytur nga kufizimet e gjithanshme, atëherë vuajtjet e saj nuk do të kishin kuptim nga pikëpamja njerëzore. “Hakmarrja është imja; unë do ta shpaguej” është marrë nga letra e Palit drejtuar romanëve; ajo është në mesin e një pjese të bukur mbi vështirësitë e pranimi të padrejtësive dhe dallimeve. “Ne kemi shumë gjymtyrë në trupin tonë,” thotë Pali, “por jo të gjithë gjymtyrët kanë të njëjtin funksion.”

“Dhe tani, duke pasur dhunti të ndryshme sipas hirit që na u dha, nëse kemi profecinë, të profetizojmë sipas masës së besimit; nëse kemi shërbim, le t’i kushtohemi shërbimit; po kështu mësuesi të jepet pas mësimit; dhe ai që nxit, le t’i kushtohet nxitjes; ai që ndan, le ta bëjë me thjeshtësi; ai që kryeson le të kryesojë me zell; ai që bën vepra mëshirë, le t’i bëjë me gëzim... Mos u hakmerruni për veten tuaj, o të dashur, por i lini vend zemërimit të Perëndisë, sepse është shkruar: ‘Mua më përket hakmarrja, unë kam për të shpague, thotë Zoti’”.

Të lexosh “Ana Kareninën” do të thotë ta duash Anën. Ajo është një prej personazheve më të mira në letërsi; të gjithë tek “Ana Karenina” e duan atë, sikundër e duam edhe ne. Kur lexon për luftën e saj, të vjen natyrshëm të duash ta kuptosh. A duhet Ana të duartrokitet për pasionin e saj, apo të dënohet për marrëzinë e saj? A është ajo për t’u admiruar apo përbuzur? Wright dhe Stoppard e dinë se “Ana Karenina” të shtyn t’i harrosh këto pyetje. Në minutat e fundit, filmi i tyre të kërkon të mendosh thellë për padrejtësinë dhe mosnjohjen e gjithçkaje. Duke parë Levinin me Kitin dhe foshnjën e tyre në minutat e fundit të filmit, thua sa të bekuar janë. Vikanderi dhe Gleeson shkëmbejnë një vështrim të heshtur, me respekt, dhe në atë vështrim shihet vetëdijen e tyre lidhur me lumturinë e tyre të pamerituar – me hirin e Zotit. Megjithatë, filmi nuk arrin dot t’i shpëtojë plotësisht të rrënjësorit në historinë e dashurisë. Personazhet e tij janë tepër të përcaktuar—Ana e keqe, Kiti e përkorë—duke mos na rrëfyer mjaftueshëm nga jeta e tyre e zakonshme, aspak romantike që ne të kuptojmë se sa të ngjashme janë ato me njëra tjetrën. Film i Wright-it na paraqet vetëm personazhet që bien në dashuri. Romani i Tolstoit e merr shtruar, duke na rrëfyer se si këto personazhe luftojnë dhe ngurojnë, mendojnë dhe shohin, imagjinojnë dhe debatojnë, vuajnë dhe falin. Ai ngrihet mbi çështjet shumë njerëzore të adhurimit dhe dënimit, mbi ç’mund të kishin qenë dhe ç’duhet dhe ç’nuk duhet të kishin bërë, duke na thënë thjesht: kështu e kanë këto punë. Jini falënderues për lumturinë që keni.



2 “The Hedgehog and the Fox” ese e shkruar nga filozofi Isaiah Berlin në 1953.

SOT 94 VJETORI I LINDJES SË G.G. MARQUEZ

Një nga kryeveprat e
romancierit më madhështor të
botës... I guximshëm, energjik,
tallës ndaj vetes, evokues i
fuqishëm dhe tejet zbulues.

—*The Washington Post*



G. G. MÁRQUEZ

jeto për ta treguar

OnufriKujtime

